



# USHTRIA



Viti i 69-të i botimit Nr. 49 (82650)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 18 dhjetor 2015



**Ceremoni e ndërrimit të komandantit të Policisë Ushtarake**

» faqe 3



**Prezantohet komandanti i ri i Komandës Mbështetëse**

» faqe 3



**Ceremonia e ndërrimit të komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë**

» faqe 4

## IN MEMORIA

### Ansambli i Ushtrisë, burim trashëgimie i atdhedashurisë dhe artit kombëtar



#### Takimi

**Ministrja Kodheli priti ministren e Mbrojtjes të Gjeorgjisë, Tinatin Khidasheli**

Ministrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, priti homologen e saj gjeorgjane, znj. Tinatin Khidasheli, e cila në krye të një delegacioni të lartë ndodhet në vendin tonë për një vizitë zyrtare. Pas këtij takimi ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe ministrja e Mbrojtjes së...

» faqe 2



» faqe 8-9



#### Retrospektivë

**Flota Ushtarake Detare, në 90-vjetorin e krijimit të saj**

Në vitin 1981, shkova në Bazën Ushtarake të Pashalimanit për një bisedë me oficerë të Flotës dhe ata të Bazës së Nëndetëseve. Ishte një bisedë në stilin e bashkëbisedimeve që zhvilloheshin në atë kohë, ku flitej për vigjilencë, për të ruajtur të pacenuar...

» faqe 8



#### INTERVISTA

**Dëshiroj që edhe nga fëmijët e fëmijëve të mi të kishte një brez ushtarakësh**

» faqe 12-13

#### ANALIZAT VJETORE

**Qendra e Bashkuar Operacionale bën bilancin e punës për vitin 2015**

faqe6

#### NATO

**Në forcim të trajnimit për të drejtën humanitare ndërkombëtare**

faqe 14

# Ministrja Kodheli priti ministren e Mbrojtjes të Gjeorgjisë, Tinatin Khidasheli

**M**inistrja e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, priti homologen e saj gjeorgjane, znj. Tinatin Khidasheli, e cila në krye të një delegacioni të lartë ndodhet në vendin tonë për një vizitë zyrtare.

Pas këtij takimi ministrja e Mbrojtjes Kodheli dhe ministrja e Mbrojtjes së Gjeorgjisë Khidasheli nënshkruan Memorandumin e Mirëkuptimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet ministrive të mbrojtjes së dy vendeve tona.

Në vijim, dy ministrat e Mbrojtjes dhanë nga një deklaratë për shtyp.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, ndër të tjera, tha se, i shpreha Ministres Gjeorgjiane vlerësimin tonë më të madh për kontributin që Gjeorgjia jep si vend kandidat për anëtarësim të plotë në NATO. Kontribut që përket në reforma të guximshme dhe pjesëmarrje aktive me trupa në operacionet e NATO-s. Konfirmoj se Shqipëria ka mbështetur dhe do të mbështesë Gjeorgjinë në rrugën e saj të integritit euro-atlantik. Gjithashtu, gjatë takimit, pata mundësinë t'i rikonfirmoj qëndrimin e qeverisë shqiptare, e cila ka kundërshtuar në vijimësi njohjen nga ana e Rusisë dhe disa vendeve të tjera të "pavarësisë" së vetëshpallur të Osetisë së Jugut dhe Abkazisë. Kjo është shkelje e hapur e sovranitetit të Gjeorgjisë, - është shprehur ministrja Kodheli. Çështja e njohjes së Kosovës ishte një tjetër temë në të cilën janë ndalur dy ministret. "Ftova zonjën Khidasheli të bëhet një zë më shumë në diplomacinë e vendit të saj pro Kosovës. Rikonsiderimi i qëndrimit të Gjeorgjisë për njohjen e pavarësisë së Kosovës do të ishte një lajm i mirë për të gjithë ne", - theksoi Ministrja Kodheli.

Ndërsa ministrja e Mbrojtjes së Gjeorgjisë Tinatin Khidasheli shprehu falenderime për kontributin e veçantë dhe specifik që Shqipëria jep më lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin e bashkëpunimit të vendeve anëtare të NATO-s me Gjeorgjinë si vend kandidat. "Shqipëria ka një oficer, i cili është pjesë e këtij koordinimi dhe Shqipëria jep një kontribut shumë të vyer dhe të çmuar që ky koordinim t'i shërbejë afrimit të Gjeorgjisë si vend kandidat për tu bërë vend me të drejta të plota në NATO", tha znj. Khidasheli. Më tej ministrja e Mbrojtjes së Gjeorgjisë, duke u ndalur në sfidat e luftës kundër terrorizmit nënvizoi se, Gjeorgjia shpreh gatishmërinë e saj për të qenë pjesë e këtyre përpjekjeve të përbashkëta, përpjekje të cilat jam e sigurtë që do ti tejkalojnë dhe do të përballen në mënyrë të suksesshme me këto sfida.

Ministrja e Mbrojtjes së Gjeorgjisë, znj. Tinatin Khidasheli u prit në takim nga kryetari i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta dhe zv.kryeministri Niko Peleshi.



*Kodheli:  
Konfirmoj se  
Shqipëria ka  
mbështetur  
dhe do të  
mbështesë  
Gjeorgjinë në  
rrugën e saj  
të integritit  
euro-atlantik*



*Khidasheli: Dua t'ju  
falenderoj për kon-  
tributin e veçantë dhe  
specifik që Shqipëria  
jep më lidhje me  
bashkëpunimin dhe  
koordinimin e bash-  
këpunimit të vendeve  
anëtare të NATO-s  
me Gjeorgjinë si vend  
kandidat*

## DEKLARATA



### Deklarata për shtyp e ministres së Mbrojtjes Mimi Kodheli:

Jam shumë e nderuar të mirëpres sot, këtu, Ministren e Mbrojtjes së Gjeorgjisë, Zonjën Tinatin Khidasheli dhe delegacionin që e shoqëron. Ju falenderoj që ju përgjigjët ftesës time dhe vizituar Tiranën. Jam e bindur që kjo vizitë, si çdo mundësi më shumë për të bashkëbiseduar, forcon lidhjet dhe bashkëpunimin ndërmjet dy vendeve tona.

I shpreha Ministres Gjeorgjiane vlerësimin tonë më të madh për kontributin që Gjeorgjia jep si vend kandidat për anëtarësim të plotë në NATO. Kontribut që përket në reforma të guximshme dhe pjesëmarrje aktive me trupa në operacionet e NATO-s. Konfirmoj se Shqipëria ka mbështetur dhe do të mbështesë Gjeorgjinë në rrugën e saj të integritit euro-atlantik. Gjithashtu, gjatë takimit, pata mundësinë t'i rikonfirmoj qëndrimin e qeverisë shqiptare, e cila ka kundërshtuar në vijimësi njohjen nga ana e Rusisë dhe disa vendeve të tjera të "pavarësisë" së vetëshpallur të Osetisë së Jugut dhe Abkazisë. Kjo është shkelje e hapur e sovranitetit të Gjeorgjisë.

Ftova zonjën Khidasheli të bëhet një zë më shumë në diplomacinë e vendit të saj pro Kosovës. Rikonsiderimi i qëndrimit të Gjeorgjisë për njohjen e pavarësisë së Kosovës do të ishte një lajm i mirë për të gjithë ne. Gjatë kësaj vizite patëm mundësinë e shkëlqyer për të nënshkruar memorandumin e mirëkuptimit në fushën e mbrojtjes ndërmjet dy ministrive tona. Ky memorandum krijon bazën ligjore për intensifikimin e bashkëpunimit në të ardhmen. Jam e bindur se një ditë Gjeorgjia do të plotësojë aspiratën e popullit të saj duke qenë një partner e denjë dhe me të drejta të plota e Aleancës. Lufta kundër terrorizmit që çënon sot më shumë se kurrë sigurinë globale kërkon të jemi bashkë për të mbrojtur vlerat më të mëdha të njerëzimit. Edhe njëherë falenderoj Ministrën e Mbrojtjes së Gjeorgjisë për vizitën dhe shpreh konsideratat më të larta për punën e saj dhe të institucionit që ajo përfaqëson.

Ju faleminderit.

## DEKLARATA



### Deklarata e ministres së Mbrojtjes së Gjeorgjisë, Tinatin Khidasheli:

Faleminderit zonja ministre Kodheli për mikpritjen që rezervuat për mua si ministër i Mbrojtjes i Gjeorgjisë dhe për delegacionin tim.

Jam shumë e gëzuar që sot patëm një takim në vijim të bashkëpunimit që kemi ndërtuar së bashku. Dua t'ju falenderoj për kontributin e veçantë dhe specifik që Shqipëria jep më lidhje me bashkëpunimin dhe koordinimin e bashkëpunimit të vendeve anëtare të NATO-s me Gjeorgjinë si vend kandidat. Shqipëria ka një oficer, i cili është pjesë e këtij koordinimi dhe Shqipëria jep një kontribut shumë të vyer dhe të çmuar që ky koordinim t'i shërbejë afrimit të Gjeorgjisë si vend kandidat, për tu bërë vend me të drejta të plota në NATO. Sot ne përballlemi me sfida shumë të ndërlikuara të sigurisë. Sulmet në Paris, si dhe ngjarjet e tjera që çënojnë sigurinë globale janë një shembull i tillë dhe jam shumë dakord që kjo kërkon bashkëpunim ndërmjet vendeve tona, sidomos mes vendeve anëtare të NATO-s.

Gjeorgjia shpreh gatishmërinë e saj për të qenë pjesë e këtyre përpjekjeve të përbashkëta, përpjekje të cilat jam e sigurtë që do t'i tejkalojnë dhe do të përballen në mënyrë të suksesshme me këto sfida. Është e natyrshme që ka shumë sfida dhe çështje për të cilat ne duhet të punojmë së bashku. Jam e sigurtë që vullneti i mirë për tu përballur me këto sfida dhe këto çështje do të bëjë që ne të gjejmë një rrugë të përbashkët, sepse jemi në të njëjtën anë të barrikadës dhe këto përpjekje duhet të vazhdojnë edhe në të ardhmen.

Ju falenderoj edhe njëherë.



**P**as një drejtimi tepër profesional, nga kolonel Xhevdet Zeneli, nga dita e sotme Policia Ushtarake do të ketë komandantin e saj të ri, kolonel Arben Kingji. Në ceremoninë e zhvilluar me këtë rast në ambientet e Policisë Ushtarake mori pjesë: ministri e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, drejtorë dhe ushtarakë të lartë në Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm, efektivë i Policisë Ushtarake etj.

Ministrja e Mbrojtjes Kodheli, duke folur për punën e kolonel Xhevdet Zenelit në krye të Policisë Ushtarake, theksoi se "komandant Zeneli, ashtu siç ka punuar këto vitet e fundit me të cilin unë kam pasur nderin të punoj, të njëjtën devotshmëri, përkushtim, sakrificë ka pasur edhe në vitet e mëparshme. Dhe kjo, puna e tij, e ka bërë atë të drejtojë një forcë elitë të FA, siç është pikërisht Policia Ushtarake,

ku mund të themi pa frikë se jemi krenar të jemi të barabartë midis të gjithë atyre strukturave që si ju përfaqësojnë vendet në Aleancë".

Ndërsa duke prezantuar kolonel Arben Kingjin në detyrën e re të komandantit të Policisë Ushtarake, ministri Kodheli tha se, jam gjithashtu e bindur se komandant

Kingji jo vetëm do të dijë të drejtojë ashtu si paraardhësi i tij, por do të mundësojë me mbështetjen time si Ministër i Mbrojtjes, me mbështetjen e Gjeneral Bazos dhe të gjithë strukturave të tjera drejtuese të FA dhe MM, të çojmë përpara këtë strukturë elitë të FA. "Kam besimin e plotë se do të vijë dita kur e gjithë struktura juaj dhe jo

vetëm një pjesë, të mund të jeni jo vetëm pjesë aktive ashtu siç ju jeni brenda FA, brenda vendit, por një pjesë aktive në front të parë të të gjithë misionëve dhe operacioneve paqeruajtëse, trajnuese nën ombrellën e NATO-s kudo në botë", - theksoi ministri Kodheli.

Kolonel Xhevdet Zeneli shprehu fal-

enderim dhe mirënjohje për mbështetjen që ministri e Mbrojtjes Kodheli dhe shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bazo, i kanë dhënë gjatë gjithë periudhës që ai ka kryer detyrën e komandantit të PU, si dhe për të gjithë trupën e kësaj strukture të rëndësishme të Forcave tona të Armatosura. Po kështu edhe kolonel Arben Kingji vlerësoi marrjen e detyrës së komandantit të PU si një përgjegjësi të lartë dhe kërkoi nga efektivët për të vazhduar përgatitjen dhe kryerjen e detyrave me të njëjtin profesionalizëm që kanë treguar deri tani.

Më pas, ceremonia vazhdoi me një ceremonial ushtarak, ku shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo i dorëzoi Flamurin e Policisë Ushtarake komandantit të ri, gjeneral brigade Nazmi Cahani.

Të pranishmit në ceremoni, realizuan një foto të përbashkët, si një kujtim i bukur i kësaj ngjarje të shënuar jo vetëm për PU, por për të gjithë Forcat e Armatosura Shqiptare.

## Prezantohet komandanti i ri i Komandës Mbështetëse

**N**ë mjediset e Komandës Mbështetëse në Vaqarr, Tiranë, u zhvillua ceremonia e emërimit të komandantit të ri të KM-së, kolonel Fatmir Lokaj. Në këtë ceremoni morën pjesë zv.ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm i FA-së, gjeneralmajor Jeronim Bazo, komandantët e Forcave, drejtues të niveleve të ndryshme në FA, atashë ushtarakë të akredituar në vendin tonë, veteranë, ish-drejtes të kësaj strukture në vite, efektivë të KM-së etj.

Mbas ekzekutimit të Himnit Kombëtar të pranishmit i përshëndeti zv.komandanti i KM-së, kolonel Petrit Dajlani, i cili theksoi përkushtimin maksimal të efektivit të KM-së në përmbushjen e misionit kushtetues, si dhe falenderoi për mbështetjen e dhënë nga drejtuesit më të lartë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Shtabit të Përgjithshëm të FA-së.

Ceremonia vijoi me simbolikën më të rëndësishme për strukturën e KM-së, dorëzimin nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Jeronim Bazo, të Flamurit Luftarak të KM-së, komandantit të sapoemruar, kolonel Fatmir Lokaj. Mbas marrjes së flamurit të njësisë, komandant Lokaj, pasi falenderoi Ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e SHP të FA-së për besim e dhënë në emërimin në këtë detyrë të rëndësishme, shtoi se vjen në këtë detyrë i vetëdijshëm për rolin dhe misionin shumë të rëndësishëm dhe të veçantë që ka KM-ja në përbërje të FA.

Zv.ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, i uroi kolonel

Fatmir Lokës suksese në detyrën fisnike të komandantit të KM-së, që së bashku me efektivat që do të drejtojë të përmbush me sukses detyrimin kushtetues të ngarkuar. Zv.ministri Koçi një urim të veçantë bëri edhe për efektivat e KM që ndodhen me shërbim jashtë vendit si në Mali të Afrikës, Gjeorgji dhe në Afganistan. Në perfundim të fjalës së tij ai i uroi efektivit të KM arritje të metejshme



në misionin e tyre kushtetues, si dhe një urim të veçantë për festat e fundvitit.

Kolonel Fatmir Lokaj vjen në detyrën e komandantit të KM-së pas një karriere të gjatë dhe të suksesshme në Forcat e Armatosura.

Kapiten Karafil Celibashi



# Ceremonia e ndërrimit të komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë

**P**ara disa ditësh, në ambientet e garnizonit ushtarak të Zall-Herrit u zhvillua ceremonia e ndërrimit të komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë të Forcës Tokësore. Në këtë ceremoni mori pjesë: komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani, zv.komandati i FT-së, gjeneral brigade Muhamet Buçpapaj, përfaqësues nga Shtabi i Përgjithshëm i FA, nga shtabi i FT, si dhe komandantët e reparteve vartëse të Forcës Tokësore.

Ceremonia u hap me leximin e urdhërit të Ministrit të Mbrojtjes për emërimin e kolonel Ylli Pulajt në detyrën e komandantit të Batalionit të Dytë të Këmbësorisë (b2k), detyrë të cilën deri tani e mbante kolonel Edmond Sardi.

Në fjalën e tij përshendetëse, kolonel Sardi shprehu falenderimin dhe mirënjohjen e thellë për të gjithë efektivin e b2k, me të cilët pati nderin të shërbente. Ai do të veçonte tre momente kryesore, gjatë punës së përbashkët me efektivin e këtij reparti të mirënjohur të FT. Së pari, kolonel Sardi vlerësoi "certifikimin në muajin qershor 2014 në nivel batalioni; së dyti pajisjen dhe futjen në përdorim të armatimit të ri standart i NATO-s për të gjithë efektivat e b2k dhe, së fundmi, por jo për nga rëndësia, pjesëmarrjen në stërvitjen më të madhe të NATO-s pas 25 viteve, siç ishte "Sardenja-15", ku për herë të parë efektivi i kompanisë së dalë nga b2k veprroi si i pavarur nga ana logjistike dhe mori vlerësimet më të larta nga drejtuesit e stërvitjes". Në mbyllje të fjalës së tij, kolonel Sardi



falenderoi Ministrin e Mbrojtjes dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm për besimin që ata patën kur e emëruan në detyrën e rëndësishme të komandantit të b2k. Mirënjohje e veçantë nga ana e kolonel Sardit shkoi edhe për ish-komandantin e Forcës Tokësore, gjeneralmajor Zyber Dushkun, lidërshpi i të cilit, sipas kolonel Sardit, është burim frymëzimi. Gjithashtu, ai falenderoi edhe komandantin e FT, general brigade Cahanin për mbështetjen që gjeti tek ai dhe shtabi i FT, pavarësisht kohës së shkurtër gjatë së cilës

punuan bashkë.

Ceremonia vazhdoi më pas me përshëndetjen e komandantit të ri të b2k, kolonel Ylli Pulaj, i cili fillimisht falenderoi ministrin e Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli, si dhe shefin e Shtabit të Përgjithshëm, gjeneralmajor Bazon, për besimin që patën në emërimin e tij në krye të b2k. Ai garantoj jo vetëm ata, por edhe komandantin e FT, general brigade Cahanin, se nivelin e lartë të operacionalitetit dhe punën e mirë që është bërë nga paraardhësi i tij, kolonel Sardi, jo vetëm që nuk do ta ulin nga

ai nivel, por do të mundohen që me punën e të gjithëve bashkë ta çojnë edhe më lart, duke iu përgjigjur kërkesave dhe standardeve që koha kërkon për trupa të nivelit të operacionalitetit të lartë, siç janë trupat e b2k.

Komandanti i FT, gjeneral brigade Nazmi Cahani, duke marrë fjalën për të përshëndetur ceremoninë ndër të tjera tha: "Ceremonia e sotme është një dëshmi vlerësimi dhe respekti e një tradite pozitive, pasi ceremoni të tilla përveçse përcjellin emocione të veçanta, nxjerrin në pah edhe

kontributin e dhënë nga të gjithë". Komandanti i Forcës Tokësore i shprehu falenderimet dhe vlerësimet e tij kolonel Sardi, i cili, sipas tij, drejtoi me profesionalizëm dhe disiplinë të lartë për përmbushjen e objektivave të b2k, si repart prioritar i Forcave të Armatosura. Në të njëjtën kohë, ai i uroi sukses në detyrën e re kolonel Ylli Pulajt, si komandant i b2k, duke shprehur bindjen e tij se me përvojën dhe përkushtimin ndaj detyrës që kolonel Pulaj mbart, b2k do ta lartësojë më tej performancën e tij në të gjithë spektrin e detyrave.

## Komandanti i Forcës Tokësore priti atasheun e Republikës së Turqisë

Atasheu ushtarak i Republikës së Turqisë në Tiranë, kolonel Bayram Tasçi, bëri një vizitë në Komandën e Forcës Tokësore në Zall-Herr, i shoqëruar. Ai shoqërohej nga zëvendësatshu, nënolonel Raif Sarica. Fillimisht atasheshu turk u prit nga komandanti i Forcës Tokësore, gjeneral brigade Nazmi Cahani. Gjatë bisedës me kolonel Tasçi, gjeneral brigade Cahani, në emër të Forcës Tokësore, falenderoi miqtë turq për vizitën në ambientet e Komandës së Forcës Tokësore, si dhe vlerësoi marrëdhëniet me Forcat e Armatosura turke si të një rëndësie të veçantë për Forcat tona të Armatosura. Me këtë rast, gjeneral brigade, nëpërmjet atasheut turk në vendin tonë, falenderoi edhe një herë Forcat e Armatosura të Turqisë për kontributin dhe ndihmën e çmuar që kanë dhënë për reformimin dhe modernizimin Forcat të Armatosura Shqiptare.

Atasheu i Republikës së Turqisë, kolonel Bayram Tasçi, i shprehu urimet më të mira gjeneral brigade Cahanit për detyrën e tij të rëndësishme në krye të Forcës Tokësore. Njëkohësisht ai falenderoi komandantin e FT për pritjen e



ngrohtë dhe vëllazërore që i rezervohet sa herë që viziton Komandën e FT. Krahas urimeve të rastit për marrjen e detyrës, në takim u diskutuan edhe çështje të bashkëpunimit dypalësh midis Forcave të Armatosura të Republikës së

shumë të mirë që kanë treguar trupat shqiptare që veprojnë me kontingjentin turk në Afganistan. Ata gjithashtu shprehën gatishmërinë për mbështetjen e mëtejshme të kontingjentit tonë për kryerjen me sukses të misionit.

**Përgatiti: Kapiten Ervin Hodo**

Turqisë dhe Forcave Tokësore të Republikës së Shqipërisë. Në takim u vlerësua niveli shumë i mirë i bashkëpunimit të deritanishëm në fushën e stërvitjes, në të cilën janë të angazhuar dy specialistë turq të atashuar pranë Batalionit Komando, si dhe në fushën e mbështetjes logjistike, në mjetet e transportit të ardhura nga Turqia etj. Një vend të veçantë zunë diskutimet për bashkëpunimin me FA të Turqisë, në pjesëmarrjen në operacionin në kuadër të RSM në Afganistan. Pala turke shprehu konsiderata të larta për bashkëpunimin e frytshëm dhe performancën

# Përdorimi i teknologjisë së avancuar në luftë



Nënkolonel VLADIMIR IMERAJ

Ndryshimet në fushën e teknologjisë janë dhe do të mbeten një nga sfidat më të mëdha për Forcat e Armatosura të çdo vendi dhe Aleancën me qëllimin e vetëm ushtarak në planëzimin e operacioneve, përcaktimin dhe zgjedhjen e objektivave, goditjen dhe shkatërrimin e kundërshtarit dhe realizimin e misionit. Në luftërat konvencionale (përfshirë këtu gjeneratën e dytë, të tretë dhe një pjesë të gjeneratës së katërt), zhvillimet teknologjike i dhanë përparësi mjaft të madhe përdorimit të armëve të reja me saktësi goditëse, zbulimit dhe përcaktimit të objektivave strategjik/operativ/taktik, komandim kontrollit, lëvizshmërisë dhe manovrueshmërisë së forcave, luftës elektronike, si në sulm ashtu dhe në mbrojtje.

Zhvillimi i teknologjisë pati efekt dominues që në Luftën e Parë Botërore dhe veçanarisht në Luftën e Dytë Botërore. Prodhimi për herë të parë i tankut, rritja e fuqisë së zjarrit, përdorimi i aviacionit solli një risi të re në këtë luftë. Nëndetëset, anijet luftarake, sollën një ndryshim rrënjësor të luftës krahasuar me luftën në terren. Përdorimi i aviacionit shtoi një dimension të ri të luftës në ajër krahasuar me luftën në det dhe në tokë. Gjatë Luftës së Dytë Botërore, zhvillimi i radarit dhe mjeteve të tjera zbuluese ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve në Paqësor dhe Atlantik. Bomba bërthamore, zhvillimi i aviacionit, nëndetëset bërthamore dhe shumë armatime të teknologjisë moderne bënë që gjatë Luftës së Ftohtë, të dy kampet të kishin frikë përballjen me njëri-tjetrin. Në ditët e sotme zhvillimet teknologjike ushtarake kanë pësuar ndryshime esenciale. SHBA, Rusia, Kina, Japonia e shumë shtete të tjera të zhvilluara, në buxhetet e tyre për mbrojtjen i kushtojnë rëndësi modernizimit të Forcave të Armatosura me teknologjinë e fundit të armatimeve për të përballuar sfidat e luftës.

Shumë strategë, studiues e ushtarakë me të drejtë shtrojnë pyetjen se zhvillimet teknologjike a favorizojnë atë që sulmon apo atë që mbrohet? Njëra rrugë për të dhënë këtë përgjigje është duke shqyrtuar efektet e teknologjisë në prespektivën historike. Disa studiues si Montross, Ëright, Gibson, Alexandroff, kanë dhënë idenë se gjatë viteve të luftërave, teknologjia ushtarake ka favorizuar mbrojtësin. Ndërsa Liddel Hart, Fuller, de Gaulle dhe Guderian janë shprehur se teknologjia ushtarake ka favorizuar sulmin. Megjithatë, bilanci i teknologjisë ushtarake në bazë



të analizave historike nuk përcakton një raport të drejtë nëse kjo teknologji i ka shërbyer apo i shërben më mirë atij që mbrohet apo atij që sulmon.

Pjesëmarrja e FA-së në misionet paqeruajtëse (edhe misionet luftimi) ka sjellë domosdoshmëri në modernizimin e tyre. Gjatë viteve të fundit, janë bërë përpjekje të mëdha për pajisjen e tyre me teknologji të avancuar ushtarake. Kështu vlen të theksojmë se janë ndërtuar rrjete kompjuterike të klasifikuara dhe të paklasifikuara, rrjeti sekret i NATO-s, repartet më prioritarë janë të pajisura me radio të prodhimeve të fundit të cilat janë të ndërveprueshme me ato të koalicionit dhe vendeve partnere. Blerja e helikopterëve "Cougar" kanë rritur ndjeshëm kapacitetet e Forcave Ajrore. Po ashtu ndërtimi i 4 anijeve të reja për Forcat Detare kanë dhënë një impakt të madh në zhvillimin e tyre. Po bëhen hapa të mëtejshme për kompletimin me pajisje dhe armatim personal të teknologjisë së fundit për trupave luftime.

Natyrë e teknologjisë. Teknologjia ushtarake ndahet në teknologji sulmuese dhe mbrojtëse. Armët e teknologjisë së avancuar përdoren si sulm dhe në mbrojtje. Edhe pse limitet që ka terreni, moti, mosnjohja e kundërshtarit, teknologjia e re e armatimit çon në vlerësimin, rishikimin e doktrinave, planeve taktike dhe zhvillimin e strategjive të reja të luftimit. Karakteristikat kryesore të Luftës Teknologjike të avancuar janë dinamizmi dhe elasticiteti. Sa më dinamike të jenë armët në fushën e luftimit, sa më elastike të jenë gjatë manovrës, sulmit apo mbrojtjes, aq më të sukseshme do jenë ato në

përmbushjen e misionit. Nëse shohim zhvillimet teknologjike të viteve të fundit në luftën detare, është e qartë se teknologjia ka sjellë risi të re në këtë luftë.

Gjatë Luftës së Ftohtë, të dy superfuqitë zhvilluan një garë armatimi me kosto mjaft të lartë. Për modernizimin e Flotës Luftarake Detare u instalua armatimi bërthamor në nëndetëse (atomik, neutron, hidrogjen), reaktorë bërthamorë, raketa balistike. Pajisjet opto-elektronike të drejtimit të zjarrit (të të gjitha kalibrave) u përfeksionuan. Pajisjet opto-elektronike të zbulimit dhe të drejtimit të mjeteve detare rritën ndjeshëm aftësinë për përcaktimin e saktë të objektivave. Rritja e manovrueshmërisë dhe e shpejtësisë të mjeteve luftime ishte parimi kryesor në doktrinën e tyre. Pajisjet elektronike dhe satelitore të lundrimit u instaluan në të gjitha llojet e anijeve apo mjeteve detare luftarake. Të gjitha këto pajisje, mjete, sisteme rritën kapacitetet e luftës në det, ku natyrisht, SHBA pati ndikim më të madh në dominiminë detare dhe oqeanëve në të gjithë botën.

Armatime të reja teknologjike. Aktualisht, përveç armëve bërthamore, teknologjitë e reja kryesore të pajisjeve ushtarake janë raketat, sistemet me pajisjet zbuluese, lufta elektronike, dhe teknologjitë e reja të C4 (komandim/kontroll/komunikim/kompjuter). Përmirësimi i mëtejshëm i mjeteve të blinduara dhe aviacionit kanë bërë të mundur dominimin në fushën e betejës që nga Lufta e Dytë Botërore e deri në ditët e sotme. Mjaft shtete dhe kombe shpenzojnë mjaftueshëm për modernizimin e Forcave të Armatosura.

Teknologjia e raketave dhe anti-

## Rubrika: Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA

Studentët pjesëmarrës në KLO kanë nisur realizimin e shtyrave individuale, sipas temave të lëndës "Teori të luftës dhe strategjisë", nën drejtimin e pedagogut Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj. Me këtë rast, gazeta "Ushtria" çel rubrikën "Flasin studentët e Kursit të Lartë të Oficerit në AFA" nëpërmjet së cilës do të pasqyrojë herë pas here esse, recensa dhe opinione të përzgjedhura nga studentët pjesëmarrës në këtë Kurs, të cilat gjykojmë se vlejné të njihen dhe studiohen edhe nga ushtarakë të tjerë të niveleve të ndryshme të Forcave tona të Armatosura.

raketave. Konsiston kryesisht në precizionin goditës të drejtuar të raketave (precision guided missiles (PGM), silure e nëndetësve (cruise missiles CM) dhe raketat balistike (tactical ballistic missiles TBM) të cilat përdoren për goditjen e objektivave strategjik. Teknologjia anti-raketë është hedhur për herë të parë si ide nga administrata e Presidentit Regan, në SHBA për mbrojtjen e vendit dhe të aleatëve nga kërcënimet e raketave me rreze të gjatë veprimi. Edhe në ditët e sotme SHBA po punon shumë për të krijuar një mburojë antiraketë.

Balanca mbrojtëse dhe sulmuese. Raketat me precizion të drejtuar (PGM), siluret CM dhe raketat balistike TBM janë armë taktike sulmuese të cilat rrisin në mënyrë të jashtëzakonshme kapacitetet shkatërruese ndaj elementëve kyç të kundërshtarit. Megjithatë, kostoja e lartë e prodhimit të tyre ndoshta do të krijojë paqartësi për pjesën civile në SHBA dhe për vendet e NATO-s, dhe për ndërtimin e sistemit antiraketë. Për këtë arsye, trendet e sotme duket se përbëjnë një forcim teknologjisë për prodhimin e raketave të natyrës taktike sulmuese ndaj atyre mbrojtëse.

Nëse analizojmë luftën e Izraelit me Organizatën HAMAS, është e qartë se goditjet dhe kundërgoditjet me raketa janë në plan të parë për të dyja forcat. Izraeli godet bazat e lëshimit të raketave, godet trafikun e paligjshëm të armëve të këtij grupi, elementët e komandim kontrollit të HAMAS-it. Me anë të teknologjisë së avancuar (forcat ajrore) Izraeli ka realizuar operacione të sukseshme në shkatërrimin e grupeve separatiste. Theksojmë së ushtria Izraelite është një ndër ushtritë më të mirëpajisura me teknologji moderne të armatimit. Këtë teknologji e ka shfrytëzuar në luftën ndaj Egjiptit, Sirisë dhe në ditët e sotme po e shfrytëzon fuqinë luftarake për të bërë presion Iranit.

Zbulimi me mjetet satelitore. Nëpërmjet satelitëve, UAV-ve, radarëve, sistemet pamoro-optike, bëhet e mundur marrja e pamjeve të sakta të terrenit, motit, lëvizjes së kundërshtarit në fushë-betejë në kohë reale. NATO përdor sistemin Blue Force

Tracker për të kontrolluar lëvizjen e forcave të veta, por edhe atyre të kundërshtarit. Një komandant duhet t'i caktohen asete të mjaftueshme të grumbullimit e të analizës së të dhënave të zbulimit, vëzhgimit, kapjes së objektivave e përnjohjes (ISTAR) për të mbështetur misionin e tij, si dhe t'i jepet informacion nga asetet që mbahen në nivelet e tjera të komandimit. Për të siguruar një pamje gjithëpërfshirëse dhe për t'i bërë ballë veprimet të armikut si, për shembull, mashttrimin, duhet të përdoren një larmi sensorësh dhe sistemesh të cilat janë shumë të avancuara.

Komandim-kontrolli, Komunikimi, kompjuteri (C4) dhe lufta elektronike. Në ditët e sotme i është dhënë përparësi të madhe sistemit të Komandim-kontroll-komunikim-kompjuter dhe luftës elektronike. Në fushën e luftimit funksionojnë shumë rrjete kompjuterike të klasifikuara në nivelet sekret, teper sekret dhe top sekret në mënyrë që informacioni që qarkullon të mos kapet nga kundërshtarit. Po ashtu rrjetet e radiove bëhen me kriptim duke siguruar shkallë maksimale të ruajtjes së informacionit. Marrja e saktë e informacionit i jep përparësi komandim kontrollit të marrin vendimet e duhura në kohë sa më reale.

Lufta elektronike. Të gjitha pajisjet e dhe sistemet e komunikimit janë shumë të ndjeshme ndaj luftës elektronike. Në të gjitha luftërat, ai që kryen sulmin i jep përparësi bllokimit të sistemeve e pajisjeve të kundërshtarit nëpërmjet luftës elektronike për të bërë të mundur nxjerrjen jashtë loje të komandim kontrollit të tij. Të njëjtat veprime bën edhe kundërshtarit. Ai që ka sisteme e pajisje të teknologjisë së lartë të fundit është më i aftë ta fitojë luftën elektronike. Nëse analizojmë luftën elektronike (kibernetike) të ndërmarrë nga rusët në Estoni në vitin 2007, nxjerrim përfundimin se lufta elektronike është faktor kryesor për bllokimin total të shtetit. NATO, për të përballuar sulme të tilla, ndërtoj Qendrën e Ekselencës për Sulmet Kibernetike në Estoni, qendër që i shërben të gjitha anëtarëve dhe vendeve partnere të saj.

# Qendra e Bashkuar Operacionale bën bilancin e punës për vitin 2015

MIMOZA GOLIKJA

Më datën 15 dhjetor 2015 u zhvillua analiza vjetore e punës e Qendrës së Bashkuar Operacionale (QBO). Në analizë mori pjesë zv. ministri i Mbrojtjes, z. Petro Koçi, shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneralmajor Jeronim Bazo dhe këshilltari ushtarak i ministrit të Mbrojtjes, gjeneralmajor Arjan Zaimi. Në raportin e paraqitur nga komandanti i QBO-së, kolonel Ahmet Leka, theksi u vu në ndjekjen me prioritet të aktivitetit të strukturave të Forcave të Armatosura të RSH dhe të kontingjenteve me mision jashtë vendit, duke mbajtur një komunikim të vazhdueshëm me komandantin e Kontingjentit të Resolute Support Mission (RSM) në Kabul, Afganistan, si dhe me përfaqësuesin shqiptar në KFOR.

Në qendër të vëmendjes së punës së QBO-së për vitin 2015, u theksua në raport, ka qenë dhe koordinimi i veprimeve të strukturave ushtarake të deklaruara për emergjencat civile. Në këtë kuadër u përmend operacioni "Jugu-2015" ku këto struktura u angazhuan në terren, për mbështetjen e strukturave të pushtetit vendor, për shpëtimin dhe evakuimin e popullsisë së rrezikuar dhe gjësë së gjallë në zonat e prekura nga përmbajtjet në Jug të vendit. Një punë e mirë është bërë për monitorimin dhe koordinimin e operacioneve për shuarjen e zjarreve në të gjithë rrethet dhe prefekturat e Shqipërisë dhe operacionit për pastrimin e ndotjes detare të shkaktuar nga anijet transite në zonën e Gjirit të Durrësit. Krahas këtyre operacioneve u theksua se QBO ka koordinuar dhe operacionet për zhblokimin e akteve rrugore të bllokuar nga dëbora, shembja masive shkëmbore dhe largimin e ujrave dhe mbeturinave të shkaktuara nga shirat në disa qytete kryesore të vendit etj.

QBO kujdes të veçantë i ka kushtuar edhe menaxhimin të operacioneve të tjera dhe atyre në ndihmë të komunitetit, si ai për largimin e kimikateve nga ish-Kombinati i Tekstileve Korçë, ripaketimit të kimikateve të rrezikshme në Qaf-Mollë, mbështetja e Forcave të Policisë së Shtetit me helikopter nga Forca Ajrore në aksionin antidrogë në Lazarat etj. Gjatë këtij viti rezultoi se QBO ka trajtuar mbi 60 kërkesa për ndihmë nga autoritete qendrore, lokale dhe private. Një angazhim mjaft të madh QBO-ja, nëpërmjet QKKSH, pati për koordinimin dhe drejtimin e kapaciteteve SAR të FA-së në Operacionin "Norman Atlantic", si dhe gjatë vitit 2015 janë marrë dhe analizuar 59 sinjale SOS.

Prioritetet e punës së QBO për vitin 2016 do të jenë në përputhje me Direktivën e Mbrojtjes së MM për vitin 2016, Matricën e Veprimtarive kryesore të FA për vitin 2016, si edhe urdhrave dhe udhëzimeve shtesë, të cilat do të orientojnë gjithë spektrin e veprimtarisë operacionale dhe administrative të QBO-së.

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FA, gjeneral Major Jeronim Bazo, duke marrë shkas nga disa probleme e shqetësime që u ngritën për funksionimin e Qendrës



Kombëtare të Kërkim Shpëtimit, vlerësoi punën e bërë deri tani dhe porositi që "punën që kemi nisur ta çojmë më tej në përputhje me aktet ligjore e nënligjore për këtë qëllim. Krahas ndryshimeve strukturore duhet punuar edhe për ndryshime ligjore me qëllim që QKKSH të jetë strukturë brenda QBO-së ashtu siç funksionon aktualisht". Ai tha gjithashtu "të vijojë puna e mirë edhe gjatë vitit 2016 duke synuar ngritjen dhe funksionimin e një grupi pune për bërjen e QKKSH së një strukturë të ngjashme me vendet analoge, ndoshta duke ribërë edhe një ligji të ri që të ketë qasje për SAR në RSH dhe në rajon dhe të përgatitet një studim për versione të mundshme të shërbimit SAR në RSH". Gjeneralmajor Bazo theksoi se "Shërbimi SAR është një shërbim civil dhe ne si Forcë e Armatosur duhet të afrojmë kapacitetet tona. Mjaft e rëndësishme për realizimin e këtij misioni

re të QBO-së. Për shërbimin SAR kemi bërë një punë të mirë deri tani, zhvilluam një konferencë për këtë qëllim, hartuam dhe një plan veprimi, por e shikoj si të domosdoshme vazhdimin e kësaj pune



**Qendra e Bashkuar Operacionale (QBO) është strukturë e FA e cila mbështet Shtabin e Përgjithshëm të FA në përmbushjen e përgjegjësi të komandimit e kontrollit në nivelin operativo-strategjik. Pas kompletimit me përfaqësues të drejtorive të SHPPFA, QBO koordinon planëzimin, organizimin dhe koordinimin e operacioneve të FA, për rastet e emergjencave e situatave kritike humanitare në të gjitha format që shfaqen dhe fazat e zhvillimit të tyre, si dhe ndjek zbatimin e detyrave të planëzuara dhe të miratuara për njësitë e repartit e FA.**

**QBO është strukturë operacionale për monitorimin dhe mbajtjen e gjendjes së gatishmërisë dhe në të njëjtën kohë strukturë administrative për ndjekjen e veprimtarive të përditshme gjatë dhe pas orarit të punës. Ajo është strukturë përgjegjëse për marrjen dhe shpërndarjen e të gjitha të dhënave të situatës për strukturat e Forcave të Armatosura, duke përfshirë dhe ato kritike. E dislokuar në ambjentet e garnizonit ushtarak "Skënderbej", QBO është në ndjekje të detyrave operative 24 orëshe në mbështetje të misionit të saj.**

janë dhe hartimi e miratimi i Procedurave Standarde sepse ato ndajnë përgjegjësitë dhe hartimi e miratimi i Planit Kombëtar SAR me produkte gjithëpërfshirëse".

Ndërsa zv. ministri i Mbrojtjes, Petro Koçi, falënderoi për punën e bërë dhe përkushtimin e treguar nga QBO veçanërisht gjatë angazhimit të FA në EC, ku ajo ka treguar përgjegjshmëri dhe profesionalizëm si për koordinimin ashtu edhe për menaxhimin e tyre. Më tej ai shtroi disa detyra për të ardhmen. "Misioni dhe përgjegjësitë e QBO-së janë të përcaktuara, por është e nevojshme një rishikim tërësor i tyre dhe hartimi i rregullores se

duke kërkuar edhe zgjidhje ligjore. Problemi SAR të bëhet përsëri objekt i një tryeze diskutimi. Po kështu edhe për HNS jemi në ngërc, kërkohet ndryshime e përmirësime të akteve ligjore e nënligjore" - theksoi zv. ministri Koçi.

Në vijim të fjalës së ti ai tha se hartimi i SOP është një detyrë tjetër mjaft e rëndësishme dhe e domosdoshme. "Duhet që procedurat standarde të hartohen në përputhje me misionin e QBO-së dhe rregulloren e funksionimit të saj. Për këtë kërkohet bashkëpunim me strukturat e tjera të FA dhe SHPPFA", nënvizoi ai. Duke përfunduar, zëvendësministri i



## Detyrat kryesore për vitin 2016:

Prioritetet e punës së QBO/QKKSH për vitin 2016 do të jenë në përputhje me

Direktivën e Mbrojtjes së MM për vitin 2016, Matricën e veprimtarive kryesore të

FA për vitin 2016, si edhe urdhrave dhe udhëzimeve shtesë, të cilat do të orien-

tojnë gjithë spektrin e veprimtarisë operacionale dhe administrative të QBO-së,

si hallka kryesore e ushtrimit të autoritetit të Komandim Kontrollit të FA-së, nga

Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura dhe autoritetet e larta

vendimarrëse në fushën e mbrojtjes.

Mbrojtjes bëri një falënderim të veçantë për punën e bërë për krijimin e një infrastrukture bashkëkohore dhe ambienteve komode për punë në QBO.

### Detyra të realizuara gjatë këtij viti:

Menaxhimi i situatave të emergjencave civile. Nga data 1 shkurt 2015 e në vazhdim, sipas kërkesave të QKEC dhe shtabeve të Emergjencave Civile në Qarqe, realizoi planizimin, koordinimin dhe drejtimin e efektivave të FA-së në operacionin "Jugu-2015" të angazhuara në terren, për mbështetjen e strukturave të pushtetit vendor për shpëtimin dhe

evakuimin e popullsisë së rrezikuar dhe gjësë së gjallë në zonat e prekura nga përmbajtjet në Jug të vendit; Ndjekja dhe koordinimi i veprimeve të strukturave të FA-së të angazhuara në operacionin për pastrimin e ndotjes detare me hidrokarbure, të shkaktuar nga anijet transite në zonën e Gjirit të Durrësit; janë trajtuar mbi 60 kërkesa nga autoritete qendrore, lokale dhe private për raste zjarresh,

operacionin që morën pjesë FD, FAJ, QNOD për kërkimin e dy peshkatarëve të humbur në Rajonin Kepi i Palit-Kepi i Rodonit nga data 4-17 janar 2015, në operacionin në ndihmë të peshkarexhës "PARISI" me tre persona në bord që u shpëtuan dhe ankoruan në Portin Vlorës më datë 24 mars 2015, operacionin në ndihmë të peshkarexhës italiane "San Francisco" me dy persona në bord që u shpëtuan dhe ankoruan në Portin Durrës më datë 20 mars 2015, operacionin në ndihmë të Tragetit italian "AF-Francis-co", i linjës Bari - Durrës i cili pati zjarr në sallën e motorëve më datat 12-13 maj 2015 etj. Po kështu Qendra Kombëtare e Kërkim Shpëtimit, më datë 22 korrik 2015, në bashkëpunim me Drejtorinë e Përgjithshme të Emergjencave Civile, u angazhua në monitorin dhe ndjekjen e operacionit të kërkim-shpëtimit të organizuar dhe kryer nga forcat e Ministrisë së Brendshme për gjetjen e një alpinisti shqiptar të humbur në Alpet Shqiptare. Gjithsej janë koordinuar me sukses 19 operacione kërkim shpëtimi brenda zonës së përgjegjësisë SAR të RSH, ku janë shpëtuar 32 jetë njerëzore.

Menaxhimi i situatave në ndihmë të komunitetit. Gjatë vitit 2015 janë ndjekur dhe raportuar në kohë operacionet që kanë patur Forcat e Armatosura në ndihmë të komunitetit, Inspektoriatit Kombëtar Urbanistik (INUK), operacionit për largimin e kimikateve nga ish Kombinati i Tekstileve Korçë, operacioni për mbështetjen e Forcave të Policisë së Shtetit etj.

Hartimi i procedurave standarde. Në përmbushje të misionit dhe LDTHM të QBO-së, zbatimit të detyrave të planëzuara në matricën vjetore, dhe në kushtet e vakuimit të krijuar nga mungesa e Rregullores së Gatishmërisë Luftarake të Forcave të Armatosura, personeli i QBO-se, me grupe pune, ka hartuar Procedura Standarde Operacionale me qëllim koordinimin dhe unifikimin e veprimtarisë së strukturave të FA, në rastet e angazhimit në EC, operacione SAR, kalimeve transite si vend pritës (HNS), ndodhjes së ngjarjeve të jashtëzakonshme etj.

Investimet dhe infrastrukture. Vlen për tu përmendur investimi i kryer për rikonstruksionin e ambienteve të QBO-së me fondet e Ministrisë së Mbrojtjes duke krijuar ambiente komode për të gjithë personelin, një sistem ajrim-kondicionimi bashkëkohor, sistem të sigurisë dhe vëzhgimit me kamera, sistem të komunikimit dhe internetit të klasifikuar dhe të zakonshëm, sistem të mbrojtjes dhe lajmërimit ndaj zjarrit, sistem të pasqyrimit dhe vëzhgimit të situatës ajrore dhe detare si dhe ngritja e pjesshme e nyjeve hidro-sanitare.

përmbytjes, bllokim rrugësh etj.

Menaxhimi i situatave të kërkim shpëtimit. Në operacionin "Norman Atlantic" nga Forcat tona të Armatosura u angazhuan në operacion: QBO/QKKSH me 30% personel shtesë, Forca Detare/Roja Bregdetare me shtabin e saj dhe anijet e Flotiljes Detare, më datë 28 dhjetor 2014 deri më 9 janar 2015. nga FA u kryen operacion kërkimi, shuarje zjarri dhe rimorkimi nga autoritetet civile; QBO/QKKSH janë përfshirë në disa operacione shpëtim-kërkimi për peshkatarë të humbur në detë si në

# Veprimtari të Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë të Shqipërisë

*Një delegacion i SHKURSH në stërvitjen "MURGIA 2015-Giro del Falco" në Bari të Italisë*

Në kuadër të bashkëpunimit dypalësh, një delegacion prej katër vetësh i Shoqatës Kombëtare të Ushtarakëve në Rezervë (SHKURSH), i kryesuar nga presidenti i saj, kolonel (R) Thoma Konduri, me ftesë të shoqatës homologe italiane UNUCI, mori pjesë dhe ndoqi nga afër stërvitjen "MURGIA 2015-Giro del Falco", e organizuar dhe realizuar nga seksioni i UNUCI-it për Barin, nën drejtimin e kryetarit të këtij seksioni, gjeneral (R) Amato Mansi dhe kondëradmiral (R) Micele Dammicco. Në këtë stërvitje morën pjesë rreth 130 trupa, nga struktura të ndryshme të Forcave Toksore të rajonit të Pulias si: karabineria, parshutistët, kryqi i kuq ushtarak, barcelierët etj, ku 80% e tyre ishin rezervistë të këtyre strukturave. Rezervistët ishin vullnetar dhe të moshave të reja.

Tematika e kësaj stërvitjeje i përgjigjej krizës së refugjatëve në Mesdhe dhe asaj të luftës në Lindjen e Mesme. Stërvitja u zhvillua në dy faza dhe zgjati dy ditë pa ndërprerje, 28-29.11.2015. Ajo filloi në qytetin e Barit, ku u përpunuan situata të shpëtimit të personave nga mbytja në ujë dhe veprimet alpinistike u realizuan në "Parkun Akrobatik" të qytetit. Qitjet dhe garat e qitjes me pistoletë dhe automarik u zhvilluan në poligonin me armët e lehta në Barleta, qytet pranë Barit. Këtu u mbyll faza e parë e stërvitjes. Në darkë, forcat u çvendosën dhe u përqëndruan në rajonin e poligonit



kompleks ushtarak, në afërsi të qytetit Granvino. Në këtë poligon, gjatë gjithë natës deri në paraditen e dt.29.11.2015 u zhvillua faza e dytë e stërvitjes. Ajo u realizua me grupe patrullimi, sipas specifikave të forcave pjesëmarse. Itinerari i kësaj stërvitjeje isht rreth 16

km. Gjatë këtij itinerari ishin organizuar pika kntrolli dhe zgjidhje të situatave të ndryshme luftarake. Në këto pika, sipas specifikave të forcave pjesëmarse, u përpunuan variante të ndryshme që mund të ndeshen edhe në situata luftarake. Kështu mund të përmëdim

njohja e terrenit, njohja nëpërmjet imazheve të armëve, mjetve, uniformave etj. të kundërshtarit, çaktivizimi apo kalimi i zonave të minuara, përgatitja e eksplozivave dhe venosja e tyre, dhënia e ndihmës së parë dhe evakuimi i të dëmtuarve, përgatitja e zonave të

uljes të helikopterave, menaxhimi i urgjencave në bazë të praktikave të të Drejtave Ndërkombëtare, përballimi dhe tejkalimi i situatave të goditjeve kimike, baktereologjike e radioaktive, transmetimi dhe raportimi i situatave etj. Çdo situatë përpunohej me kohë të normuar. Në të gjitha situatat kishte forca "kundërshtarë" përballë, të imituara nga forcat pjesëmarse në këtë stërvitje.

Mbyllja e stërvitjes u bë me një ceremoni përkujtimor të të rënëve të zonës së Granvinos, në Luftën e Parë Botërore, e shoqëruar me orkestrën frymore të qytetit. Në këtë ceremoni morën pjesë qytetarë dhe drejtues të pushtetit vendor, ku kryetari i Bashkisë përshëndeti pjesëmarsit. Në fund të stërvitjes, në bazë rezultateve, u ndanë stimuj të ndryshëm. Në efektivat e këtyre forcave kishte edhe shqiptarë që tashmë janë shtetas italianë dhe të vlerësuar për kontributin e tyre. Drejtuesit e UNUCI-it për zonën e Pulias, shprehën mendimin që vitin e ardhëshëm, një stërvitje të tillë, në formë gare, mund ta zhvillojmë në vendin tonë.

**Kolonel (R) Thoma Konduri**  
Presidenti i SHKURSH

## Përfaqësues të SHKURSH në një aktivitet të CIOR, NATO në Sofje

Nga data 29 nëntor deri 2 dhjetor 2015, në Sofje të Bullgarisë, u zhvillua aktiviteti i rëndësishëm IBM-3, i CIOR, NATO. SHKURSH si anëtar i CIOR merr pjesë rregullisht në këto aktivitete. Në këtë aktivitet morën pjesë përfaqësues nga vendet e NATO-s dhe të tjerë si: USA, Itali, Hollandë, Britani e Madhe, Spanjë, Bullgari, Rumani, Norvegji, Francë, Zvicër, etj. Si një problem i rëndësishëm u diskutua në lidhje me rolin dhe angazhimin e forcave rezerviste në planin kombëtar. Roli i forcave rezerviste është domethënës në drejtim të edukimit të njerëzve dhe si një nyje lidhëse midis forcave të armatosura të çdo shteti dhe shoqërisë civile. Kjo bëhet domosdoshmëri jo vetëm për faktin se çdo vend i NATO-s mbështetet nga Neni 5 i Aleancës për mbrojtjen kolektive, por kjo do të thotë dhe se çdo vend në planin kombëtar duhet të ketë forcat e veta dhe gatishmërinë e forcave aktive dhe të strukturave rezerviste për t'u bërë ballë sfidave e rreziqeve. Kjo sot bëhet më imperative se kurrë dhe për shkak të situatave globale dhe rajonale që po kalon bota dhe të rritjes së rrezikut të terrorizmit dhe të luftës kundër ISIS.

Në Komitetin e CIMIC u diskutua dhe për problematikën që ka nxjerrë vala e madhe e refugjatëve që vijnë



nga vendet e luftës drejt vendeve të Perëndimit. Kjo temë u la për t'u zhvilluar në takimin e dimrit në shkurt 2016 në Bruksel. Ndjehet nevoja për të dhënë kontribut në veprimtarinë e CIOR në shkallë kombëtare. Kështu u diskutua me Drejtorin e Akademisë së Gjuhëve të Huaja të CIOR, pjesëmarrës në aktivitet, që në se përmbushen kushtet nga Ministria jonë e Mbrojtjes dhe nëse do bien palët dakort, pasi të jetë bërë kërkesa zyrtare nga CIOR, NATO,

të bëhet e mundur zhvillimi në ambjentet e garnizonit "Skënderbej", në periudhën 15-30 korrik 2016 të Akademisë së Gjuhëve të Huaja. Kjo është një praktikë dhe aktivitet që zhvillohet në vite, kundrejt të gjithë pagesave nga CIOR, NATO, në vendet e NATO-s me pjesëmarrjen e afërsisht 60 kandidatë ushtarakë në rezervë, nga vende të ndryshme të botës, për mësim gjuhën angleze dhe frengjisht. Nga vendi pritës kërkohet vetëm infrastruktura, ambjente për

mësimdhënie, ambient për akomodim fjetje e ushqim, ruajtje, të gjitha kundrejt pagesës nga CIOR. Mendojmë se është një rast i mirë jo vetëm që dhe Shqipëria të japi kontributin e saj, por ndihmon për imazhin e Fa të RSH dhe për vendin tonë, pa asnjë kosto, vec punës tonë vullnetare në mbështetje të tyre.

Nisur nga ngjarjet e 13 nëntorit 2015 në Paris, ku Franca përjetoi një sulm të ri terrorist, na bën ne, si anëtarë të Konfederatës Ndërkombëtare të Oficerëve në Rezervë, CIOR,

NATO, të paraqesim kuptimin e vendit dhe natyrës së ekstremizmit në sistemin ligjor. Ne besojmë se kjo pamje mund të ndihmojë në kryerjen me efektivitet të aksionit kombëtar e ndërkombëtar kundër ekstremizmit dhe terrorizmit. Kjo çështje u diskutua në aktivitet duke vënë theksin te mënyra e të kuptuarit dhe dhënien e argumentave shkencorë përsa i përket këtyre ngjarjeve. Qytetërimet, shtetet, kombet, popujt dhe të gjithë ne jemi në kohët për vendime dhe veprime që mund të ndryshojnë botën. Është i pamohueshëm fakti që ngjarjet që do të vazhdojnë nuk do të jenë as fundi i historisë, as apokalipsi i planetit, por janë momente për përgjegjësi, masa vendimtare nga ana e udhëheqësve të shteteve, organizatave kombëtare e ndërkombëtare dhe popujve. Terrorizmi, si një lloj i veçantë i luftës së armatosur është një sistem kompleks me ligjet e parimet e tij. Në këtë kontekst, në aktivitetin IBM-3, i CIOR, NATO u diskutua mjaft çështje që lidhen me këto problematika. Tashmë ekspertët e CIOR kanë bërë progres në konceptimin dhe zhvillimin e një modeli të luftës kundër terrorizmit, si një lloj i veçantë i luftës së armatosur. Dhe ky model është funksional.

**Kolonelë® Suzana Jahollari**  
Nënkolonel® Enver Ajdari

# Ansambli i Ushtrisë, burim trashëgimie i atdhedashurisë dhe artit kombëtar

ETLEVA SMAÇI

in memoria...

Shumë prej atyre që themeluan e rritën Ansamblin e Ushtrisë nuk janë më sot mes nesh. Ata tokësorët që ngrinin zemrat peshë, drithëronin tokë e qiell, sot janë larguar për të lënë pas jo vetëm një emër, por edhe një vepër. Një vepër që jo vetëm nuk humbet, por sa më shumë vitet shtohen aq më të mëdha lartësohen meritat e tyre artistike. Në emër të kësaj veprë dhe në shenjë mirënjohje të këtyre emrave salla e Akademisë së Arteve të mërkurën në mbrëmje u mbush plot. I gjeje aty të gjithë brezat. Duke filluar nga heroi i luftës, gjeneral Parllaku që mban më shumë se 90 vite mbi supe, deri tek vogëlushët, që kishin ardhur së bashku me prindërit. Mblodhi salla e vogël, por me një histori kulture të madhe e Akademisë së Arteve, artistët që i dhanë emër, shpirt, mund e sakrificë një institucioni që është i barazvlefshëm me një monument kulture, Ansambli të Ushtrisë. I mblodhi me moton e përkujtimit, i mblodhi me moton e mirënjohjes, i mblodhi me moton e vlerësimit, i mblodhi për të festuar së bashku në këtë prag festash, kur Tirana e gjithë Shqipëria kanë marrë po të njëjtin shkëlqim e dritë, si mijëra qytete të tjera në botë. Të kujtuar e të shprehësh mirënjohjen duke kujtuar. Ky ishte lajtmotivi i koncertit in memoria. Nuk besoj se shumë njerëz kanë një ide të qartë për datën e krijimit të Ansambli të Ushtrisë, por më shumë se data e tij që shkon larg në vite, në 25 korrik 1944, e rëndësishme është zanafilla e këtij ansambli, i krijuar në zjarrin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, me një pasuri muzikore këngësh partizane, që janë të mbushura plot dashuri për atdheun, plot heroizëm djemsh e vajzash që dhanë jetën në lule të rinisë. Ky ansambël i ka rrënjët tek liria, ndaj edhe historiku i tij është ndoshta më i veçantë. I veçantë edhe për faktin se ai ishte bërthama mëmë prej ku u krijuan gjithë institucionet e tjera artistike të pasluftës. Nga radhët e tij dolën kompozitorë, këngëtarë, valltarë, aktorë që gjallëruan gjithë jetën artistike në vend. Në transformimet e tij ky institucion pësoi ndryshime të vazhdueshme, por pasurinë kulturore nuk e bjeri kurrë, ajo është e pranishme edhe sot, e përshtatur me format e reja të organizimit të FA.

Nën jehonën e marshit të ushtrisë dhe këngëve partizane

*Bashkoi shokë me ne në çetë*

*Malit të lartë t'i shkojmë përprjetë*

*Se atje o shok kemi foletë*

*Ne shqiponjat shqiponjat partisian*

Salla elektrizohet nga kolazhi i këngëve partizane. Kanë kaluar 75 vjet që kur djemtë e vajzat rrokën armët e krijuan të parat formacione partizane. E bashkë me këto formacione lindi dhe kënga e pavdekshme e betejave, këngët për shokët e vrarë, këngët për lirinë.



Mund të tingëllojë pak e habitshme, por grupet e para artistike lindën pikërisht aty në luftë. Edhe ato ishin pjesë e luftës kundër okupatorit dhe çlirimtë të vëndit. Të gjithë në sallë kush më shumë e kush më pak përfshihet nga toni heroik i këngëve partizane, ato kanë forcën që edhe kur nuk i njeht shumë mirë vargjet, të ndjekësh vijën melodike ose ritmin e tyre. Po aty në sallë ka sy të përplotur, të atyre që e jetuan këtë luftë, që i krijuan këto këngë dhe veten e ndien tepër të vogël përpara këtyre gjigandëve të artit.

**I përjetshmi Gaqo Avrazi**

Janë të shumtë emrat e artistëve që kanë kontribuar në Ansamblin e Ushtrisë. Por historiku i Ansambli të Ushtrisë. Por historiku i Ansambli të Ushtrisë e ka tashmë vulën e krijuesit. Gaqo Avrazi ngelet më i spikaturit. Por ky artist i madh jo vetëm në talentin që i kishte falur natyra, por artist në shpirt nuk ka thjeshtë meritën e krijimit të Ansambli të Ushtrisë, ai ka merrtën e kthimit të këtij institucioni në një shkollë të madhe për qindra talente që do t'i bashkoheshin radhëve të Forcave të Armatosura, që do të mbanin uniformën e gjelbër, që përveç se artistë do të ishin dhe përfaqësues të ushtrisë. Në kujtim të mjeshtrit të madh Gaqo Avrazi në këtë mbrëmje miqsh, disa momente nostalgjie të mbushura plot mirënjohje e respect ndau për këtë korife të Ansambli të Ushtrisë, një mik, bashkëpunëtor, por edhe një kontribues në vite i jetës kulturore të ansambli të Ushtrisë, Alqi Lepuri. Ashtu si e kanë artistët, fare thjeshtë e natyrshëm, me fjalë të vogla zemre Alqi e nisi bisedën kështu: "kur më njoftuan për këtë koncert, mu drodh shpirti/ mu drodh zemra". Dhe sytë e tij flisnin më shumë

se mijëra fjalët të pathëna nga emocioni. Një artist që ka me mijëra orë në skenë, ditë të tëra koncerte, vite të ngarkuar me krijimtari, pushtohet nga emocioni i mirënjohjes, tek sheh se Ansambli edhe pse nuk është më pjesë e strukturave të Ministrisë së Mbrojtjes për shkak të ristrukturimit të FA, ai ngelet pjesë e memories së këtyre forcave, madje ngelet në ballë të vlerave që ka krijuar. Të mbledhësh sot në një koncert të gjithë ata kontributorë që krijuan vepra të ndryshme kulturore në emër të Ansambli të Ushtrisë, është vlerësimi

më i mirë i brezave, ndaj edhe biseda bëhet më e bukur. Teksa prezantueja e programit e mirënjohura Flutura Çangu e fton dirigjentin Alqi Lepuri të ndajë disa nga kujtimet e tij me sallën, ai i rikthehet përsëri figurës së themeluesit të ansambli të Ushtrisë, Gaqo Avrazi. Përmend emra të njohur si Mentor Xhemali, Gaqo Çako, Avni Mula, dhe emëruesi i përbashkët i gjithë këtyre emrave është fillesa e tyre e parë artistike në gjirin e Ansambli të Ushtrisë. Kurse Gaqo Avrazi ka shërbyer për ta si mentor, ai ju hapi rrugën drejt shkollimit në konservatorët më të mirë në Moskë, edhe pse vetë kishte konservatorin e këngëve partizane.

**Një paganin shqiptar në radhët e Ansambli të Ushtrisë**

Qan violinisti/ qan edhe violina. Kështu shkruante gati 30 vjet më parë gazetata franceze për të. Ky ishte i madhi Et'hem Qerimi. Violinist virtuoz që me magjinë e telave të violinës së tij na bën të përjetojmë të katër stinët, të gjitha ndenjat e mundshme njëkohësisht. Dhe ai është një tjetër emër i madh që bën pjesën në plejadën e yjeve të Ansambli të Ushtrisë. Jemi me fat që e kemi mes nesh. Kurse fati i tij hyjnor është që është bërë njësh me violinën. Nuk e kupton dot kush është më e vjetër, ai apo violin. Kurse arti i tij ngelet gjithmonë i ri. Në këtë koncert ai është përfaqësuesi më i denjë i gjithë asaj klase instrumentistësh që i dhanë jetë veprimtarive të ansambli të Ushtrisë. Kabaja e tij e famshme me violinën e bënë sallën të mos i rreshtë duartrokitjet, kurse ai si një lis me rrënjë të thella, lëshon me qindra degëzime muzikore, që harlisin shpirtin e spektatorëve në sallë. Ata që i takojnë të shkuarës mes nostalgjisë jetojnë edhe njëherë lavdinë e artit



të tyre, më të rinjtë mrekullohen me tabanin e muzikës shqiptare.

Këngëtarët e ansambli të ushtrisë

Ato kanë qenë shumë, të veshura me uniformën e bukur ushtarake, ato e çonin këngën në çdo skaj të Shqipërisë. Jo të gjitha mund të ishin të pranishme në këtë sallë. Po dy prej tyre nuk munguan t'i riktheheshin edhe njëherë të kënduarit për FA. Arta Babaramo dhe Zina Zdrava janë dy këngëtare të mirënjohura lirike që kanë lënë gjurmët e tyre në skenat ku Ansambli i Ushtrisë ka qenë i pranishëm. Sot ato rikthehen në kohë, jo vetëm si një detyrim profesional, por rikthehen në kohë për të sjellë në kujtesë emrat e munguar të kolegëve të tyre për shak të largimit nga kjo jetë. Arta Babaramo në kujtim të së madhes Vaçe Zela solli "Valsin e lumturisë". Emri i Vaçes është tepër i njohur, por karriera e saj artistike u





ndëtuar pikërisht si pjesë Ansambllit të Ushtrisë. Po kështu në vite ndodhi edhe me një tjetër emër të madh të muzikës së lehtë Tonin Tërshan. Në shumë dekada Maji, ata kanë dalë në skenë si pjesëtarë të Ansambllit të Ushtrisë, kanë rritur talentin dhe janë falur atë pa kushte publikut. Në një bisedë të

konshme kompozitorësh. Të tillë kanë qenë Çesk Zadeja, Tish Dajija, Tonin Harapi, Kujtim Laro, Nikolla Zoraqi. Por nëse ata janë pjesë e panteonit muzikor shqiptar, ata janë njëkohësisht dhe në ballinën e nderit të Ansambllit të Ushtrisë. Jo të gjithë kanë pasur fatin të kalojnë një kohë të gjatë eksperiencë

tonë.

#### Vajza e bukur e skenës shqiptare që prezantoi me uniform ushtarake në gjithë Shqipërinë

Sapo shqipton emrin e saj, Flutura Çangu, sinonimi është jo vetëm një bukuri natyrore e skalitur, por edhe një profesionalizëm i lartë në realizimin e detyrës së vështirë të prezantuesit. Një rrugëtim që e ka nisur shumë herët, në moshën 18 vjeçare. Ndoshta ishte rastësi, por duket se karakteristikat e zërit të saj kumbues si të një marshi ritmik ushtarak, prezenca e saj tepër dinjitoze, në skenë, paracaktoi edhe përfshirjen e saj në Ansambllin e Ushtrisë. Një profesion që nuk e lodhi kurrë, një profesion që e dashuroi dhe vazhdon ta konservojë me të njëjtin pasion. Më shumë se 20 vite në skenë dhe më pas, një ndërprerje po kaq e gjatë. Ikona e fjalës për mijëra shqiptarë, ju rikthye skenës pikërisht për “dashurinë e saj të parë” Ansamblin e Ushtrisë. Tepër e emocionuar rrëfen bisedën telefonike që pati me shefin e Sektorit të Aktiviteve pranë QKMBMMSHP, Gazmend Çaçi. Ishte larg atdheut, dhe pas 22 vitesh po i kërkohej të kthehej për të prezantuar një program për Ansamblin e Ushtrisë. Emocioni ishte tepër i madh, dilemat gjithashtu. Po nuk hezitoi gjatë. Vendosi të vinte. Edhe pse kishte shumë frikë brenda vetes. A do ta priste spektatori me të njëjtat ovacione si dikur? A do të kishte koncerti po atë seriozitet, po atë përkushtim? Në fakt gjithçka e surprizoi. Puna e mirë e bërë nga specialistët e Sektorit të Aktiviteve, përkushtimi i drejtoreshës së QKMBMMSHP, znj. Mirela Roshi, kujdesi i veçantë i ministrit të Mbrojtjes për të promovuar dhe ndjekur këtë veprimtari. Ndaj edhe ajo si të gjithë të ftuarit e tjerë nuk ngurron t'i fshehtë emocionet, por edhe përgëzimet me shpresën se të tjera aktivitete të ngjashme do të ketë në të ardhmen dhe ajo premtonte se nuk do të mungojë kurrë.

#### Estrada e ushtarit, motra e vogël e Ansambllit

Kështu e quajti në fjalën e tij Verdi Take, Estradën e Ushtarit, një tjetër institucion që ka gjallëruar jetën artistike të Forcave të Armatosura. Artistët e këtij institucioni i kanë dhuruar me mijëra buzëqeshje e humor spektatorëve në çdo cep të Shqipërisë, nga Vermoshi në Konispol. Edhe këtu emrat e mëdhenj nuk kanë munguar. Madje këta emra të mëdhenj këtu kanë pasur filluesin e tyre. Të tillë që kanë ngelur gjatë në mendjen e spektatorit edhe për shkak të karaktereve që krijojnë, shpesh edhe nga jeta ushtarake kanë qenë i madhi Roland Trebicka, Aleko Prodani, Veli Rada, Koco Devole, Cekja i famshëm, Behar Mera etj. Drejtuesi i Estradës së Ushtrisë, Verdi Take, solli një fakt shumë interesant për të pranishmit në sallë. Estrada zhvillonte turne në gjithë vendin, edhe në postat kufitare më të largëta, pra nuk kishte asnjë njësi ushtarake, e cila përgjatë viteve që ky institucion zhvilloi aktivitetin e vet, të mos kishte parë të paktën një shfaqje artistike. Por pjesë e estradës ishin edhe kompozitorët e talentuar, si Alfred Kaçinari, Edmond Zhulali etj.

#### Orkestra frymore e Ansambllit të Ushtrisë

Prej Ansambllit të Ushtrisë lindën filizat e tjerë të veprimtarisë artistike, një ndër to edhe Orkestra frymore. Nuk mund të mungonin kujtimet, nostalgjia, por edhe krenaria në këtë koncert pikërisht për këtë orkestrë dinjitoze, që jo në pak raste i është bashkangjitur ngjarjeve të mëdha artistike në vend, si festivali i RTSH, apo koncertet e Majit. Për të ndarë me të pranishmit në koncert copëza artistike, por edhe ndonjë dëshirë të pambaruar u ngjiti në skenë një ndër drejtuesit më jetëgjatë të saj nënkolonel Fatmir Foçi, Është meritë e kësaj orkestre që edukoi për disa breza ushtarakësh dashurinë për muzikën simfonike, duke krijuar kështu një traditë të munguar me edukimin muzikor klasik. Pasi Orkestra Frymore

e Ushtrisë ka një fond të pasur klasik me pjesë të kompozitorëve të huaj dhe kompozitorëve shqiptarë. Kjo është një pjesë që është trashëguar edhe në ditët e sotme, dhe aktiviteti i kësaj orkestre është një ndër modelet më të spikatura të jetës kulturore në FA.

#### Për brezat që do të vijnë

Ansambli i Ushtrisë krijoi një traditë shumë të mirë kulturore në kontekst të kohës kur u ngrit dhe eci përpara. Në ditët e sotme kur format e lirite e artit nuk mund të jenë më pjesë e kornizuar e një institucioni, padyshim ruajtja e kësaj trashgimie kulturore pikërisht si përkatesi e FA dhe njohja nga brezat është detyrë e të gjithë atyre që merren me kulturën, shtypin, marketingun në FA. Zhvillimi i këtij aktiviteti dëshmoi që sektorët e QKMBMMSHP, treguan një bashkëpunim shumë të mirë mes tyre, për realizimin me sukses të një koncerti që për nga vlerat që përcolli, si dhe për nga figurat pjesëmarrëse do t'i bënte nder edhe institucioneve më prestigjioze artistike në vend. Mbyllja e koncertit me talentin e ri, Klajdi Milla, të dalë nga grupet artistike të QKMBMMSHP, me një ndër këngët më domethënëse “Rrjedh në këngë e ligjirime”, jo vetëm e entuziazmoi sallën, por përcolli mesazhin se jeta artistike në FA vazhdon dhe premtonte shumë. Një falenderim mirënjohje shkon për të gjithë ata që punuan në realizimin e kësaj veprimtarie, Agron Goga skenarist, Eralm Himaj regjisor, Ilir Xhaxhiu skenograf, si dhe specialistëve të zyrës së marketingut. I sjellë ky koncert edhe në këtë prag festash padyshim ka qenë një dhuratë e bukur për të gjithë të ftuarit në sallë, duke i dhënë artit, kulturës dhe trashgimisë vendin e merituar. E ardhmja nuk mund të ngrihet pa të shkuarën, dhe kur në art e shkuara na ka privilegjuar duke na dhuruar thesare, është detyra jonë që t'i vlerësojmë, t'i vëmë në dukje, dhe t'i kthejmë në vlera të shtuara për Forcat e Armatosura, të brumosura me atdasheduri dhe krenari ndaj atdheut.



shkurtër me këngëtares lirike Zina Zdrava, ajo sjellë në mendje ato kohë të bukura, kur për shkak të profesionit shëtisin çdo skaj sado të largët të Shqipërisë. Pasi Ansambli ishte në turne të vazhdueshëm, kudo që kishte njësi ushtarake. Të rikthyera në skenë pas shumë kohësh, ato janë krenare që këtë rikthim e kanë bërë pikërisht për Ansamblin e Ushtrisë, këtë vatrë të ngrohtë artistike, miqësore, e plot vlera profesionale.

#### Kompozitorët e koreografët e mëdhenj shqiptarë dhe Ansambli i Ushtrisë

Muzika e lehtë shqiptare muzika operistike, e muzika popullore, padyshim ka pasur një plejadë të jashtëza-

në të, por ka mes tyre si Kujtim Laro, që i kanë kushtuar pjesën më të madhe të karrierës artistike. Krahas tyre nuk mund të anashkalohen dhe të lihen pa përmendur në këtë koncert përkujtimor, emrat e koreografëve, pasi grupi i valleve ka qenë me një përgatitje shumë të lartë. I drejtuar nga koreografi Gëzim Kaceli grupi i valleve ka qenë pjesë e pandarë e shfaqjeve të Ansambllit të Ushtrisë brenda e jashtë vendit. Pjesë e valltarëve të parë të talentuar ishin Nobert Krasniqi, Meliha Velçani etj. Kurse emra si Panajot Kanaçi e Adriatik Metuli, kanë qenë gjithashtu kontribues shumë të mirë në ecjen përpara të kësaj gjinie që ishte në fillimet e saj në vendin



## Anija “Iliria” stërvitje të përbashkët me anije të Flotës së 6-të Amerikane

Më datën 8 dhjetor 2015, anija jonë patrulluese P-131, “Iliria”, zhvilloi një stërvitje të përbashkët me anijen amerikane “USS Bulkeley”, DDG-84 në rajonin jugor të detit Adriatik. Kjo stërvitje ishte në kuadër të bashkëpunimit dypalësh midis Forcës sonë Detare dhe Flotës së 6-të të SHBA në Mesdhe. Lajmi me fotot gjatë stërvitjes është dhënë dhe në rrjetin Facebook nga Zyra e Shtypit e Flotës së 6-të SHBA, që mbulon detin Mesdhe dhe Afrikën Perëndimore. (USS Bulkeley transited the Mediterranean Sea with Albania Navy during an at-sea exercise with the Hellenic Navy, Dec. 8. Partnerships Matter). Mbas kësaj stërvitje anijet amerikane zhvilluan stërvitje dhe me anije të marinës greke. Komandanti i anijes P-131, “Iliria”, kapiten lejtant Taulant Bako, sqaron se gjatë kësaj stërvitje u zhvilluan manovra dhe patrullim i përbashkët me anijet amerikane, si dhe u praktikuan sinjalet e komunikimit midis anijeve, të cilat përdoren në skenarë të ndryshëm stërvitorë apo situatë të emergjencave detare.

Shefqet Kërçelli

Në kuadër të 90-vjetorit të krijimit të Flotës Ushtarake Detare

# NËNDETËSET

*(Përjetim nga një lundrim i nënujshëm)*



NGA VIRON KONA, SHKRIMTAR

**Vitet ikin, gjithë bujë e zhurmë,  
Plot brengë, dashuri, vuajtje dhe mall,  
Vendin e tyre e zënë net pa gjumë,  
Flokë të thinjura, rrudha në ballë.**

Delo Isufi

Në vitin 1981, shkova në Bazën Ushtarake të Pashalimanit për një bisedë me oficerë të Flotës dhe ata të Bazës së Nëndetësëve. Ishte një bisedë në stilin e bashkëbisedimeve që zhvilloheshin në atë kohë, ku flitej për vigjilencë, për të ruajtur të pacenuar kufirin detar të ujërave territoriale shqiptare... Nuk isha ushtarak, kështu që biseda u zhvillua më shumë në këndin kulturor e letrar... Kur pas bisedës po pinim kafe me drejtuesit e Bazës së Nëndetësëve, komisarari dhe komandanti i bazës më bënë një ftesë disi të veçantë, që më befaso, por edhe më emocionoi së tepërmi. Më thanë: Njëra nga nëndetëset e Bazës ka qenë në remont. Sot kemi planifikuar që të zhytemi në poligon dhe do të kontrollojmë funksionimin e motorëve të saj.

- Në poligon? - pyeta, ngaqë nuk e kuptova se për çfarë lloji poligoni bëhej fjalë.

- Kështu quajmë zonën nënujësë, ku bëjmë kontrollin e nëndetësëve pas remontit, - më shpjegoi komandanti. - Kjo zonë ndodhet në territorin ujor të bazës, në thellësinë rreth 30 metra. Pas përfundimit të manovrave të nevojshme, do të lundrojmë për rreth 15-20 minuta nën ujë, pastaj do të dalim në sipërfaqe dhe do të kthehemi në bazë. Zhytjen do ta bëjmë pas disa minutash. Nëse dëshiron, eja edhe ti me ne.

\*\*\*

E kisha pasur gjithnjë ëndërr lundrimin me nëndetëse. Fëmijërinë e kisha kaluar në bregun e detit, në Skelë të Vlorës, pasi aty kisha edhe shtëpinë. Sapo ngrihesha në mëngjes dhe dilja në oborr, vështrimi më shkonte te sipërfaqja e ndritshme e detit të Gjirit të Vlorës, te gadishulli i Karaburunit dhe ishulli i Sazanit. Por, sidomos tek anijet dhe vaporët që hynin në port dhe, pastaj, duke u rënë sirenavë, dilnin në detin e hapur. Më kujtohet, se kur rastiste të dallonim nga larg ndonjë nga nëndetëset e Bazës së Pashalimanit, që lundronte mbi ujë, të gjithë ne fëmijët, duke përqendruar vështrimet dhe duke bërë me dorë në atë drejtim, thërrisnim me ngazëllim: "Nëndetësja!" "Nëndetësja!" - dhe e shoqëronim me kërshtëri të madhe atë trup gjigant përgjatë lundrimit.

Si të gjithë të rinjtë, edhe unë kisha lexuar librin e famshëm të Zhyl Vernit "20.000 lega nën det" dhe kisha mbetur i mahnitur nga aventurat nën ujë të

nëndetësës "Nautilus", kapitenit Nemo dhe të ekuipazhit misterioz. Po kështu na dukeshin tërheqës filmat me ngjarje nga Lufta e Dytë Botërore, që tregonin luftimet e nëndetësëve me njëra-tjetrën në ujërat e deteve dhe oqeanëve. Vite më vonë, për shkak edhe të detyrës që kryeja, krijova njohje me shumë ushtarakë të Flotës dhe të Bazës së Nëndetësëve. I shikoja mëngjesëve, veshur me uniformat e veçanta të tyre, kur niseshin për në Bazën e Pashalimanit, të Sazanit apo në bazat e tjera ushtarake të Gjirit të Vlorës. Por, tjetër gjë është t'i shihje ata, atje, në krye të detyrave luftarake, në anijet mbiujësë: dragaminat, gjuetësat, katër siluruesit ose në nëndetëset...

\*\*\*

Kështu, që, ftesa e drejtuesve të Bazës së Pashalimanit, krahas anës emocionale, po më çonte drejt realizimit të asaj ëndërr dhe dëshire, të cilën e kisha që kur isha fëmijë, por, edhe po më dukej një aventurë e bukur që do të më linte mbresa të thella. U afroam te njëra nga nëndetëset. Nuk ia mbaj mend as numrin dhe as emrin, mbase, ngaqë atëherë ato konsideroheshin sekret ushtarak. Më pas, mësova se emrat e tyre ishin "Tufani", "Vetëtima", "Rrufeja" dhe, e katërta, ajo e famshme, që nuk ia mësova dot emrin e vërtetë, por që aso kohe të gjithë e njihnim me emrin "Nëndetësja 105". Filmi shqiptar i suksesshëm i asaj kohe "Ballë për ballë", e bëri atë nëndetëse të famshme edhe në letërsinë artistike dhe kinematografi.

Komandanti dhe oficerët e nëndetësës dolën në bord, u rreshtuan dhe paraqitën gatishmërinë dhe detyrën që do të kryenin. Në raportim u përmend edhe emri im, që, sipas rregullores, u regjistrua në librin e nëndetësës. U futëm brenda mjetit lundruar nëpërmjet shkallëve të ngushta dhe shpejt u gjendëm në lokalitë e komandës, ku ndodheshin shumë aparatura dhe periskopi. Komandanti u këshillua për diçka me komisararin e bazës, pastaj dha urdhër për mbylljen e kapakut të jashtëm. Nisi kryerja e manovrave dhe nëndetësja po zhytej. Mjediset e brendshme dhe hapësirat për të lëvizur ishin tepër të ngushta, ndërkohe që zhurma që bënin motorët e fuqishëm ishte e madhe. Isha përfshirë i tëri në ngjarjen që po përjetoja. Oficerët dhe komisarari që rrinin pranë meje, herë-herë shihnin nga unë dhe bënin buzën në gaz. Marinarët dhe oficerët kryenin detyrat,

nxehtë. Marinarët dhe oficerët ishin me veshje tepër të lehta.

- Ky tip nëndetëse, - tha komisar Kujtimi, - mund të qëndrojë deri në 30 ditë nën ujë. Veç kësaj, nëndetësja ka pajisje dyfishe. Nëse prishet njëra ose bllokohet, vihet në funksionim pajisja tjetër.

Gjatë kohës që kryhej manovra, herë-herë dëgjoheshin gumëzhima dhe vibrime. Ndonjëherë trupi i nëndetësës dridhej, duke shkaktuar një panik të fshehtë brenda meje. Por, kur shihja natyrshmërinë dhe qetësinë në fytyrat dhe lëvizjet e detarëve që kryenin detyrat e tyre, ndihesha më i qetë. I vura veshin bisedës që bënin komisarari me dy oficerë. Ata po përmendnin me respekt kolegët e tyre; tregonin ndonjë ngjarje interesante që u kishte mbetur në mendje, sidomos për kohën kur rusët tentuan të rrëmbenin anijet dhe nëndetëset nga Baza Ushtarake e Vlorës; komentoni shprehjen e Hurshovit se "tani që u shkëputën nga ne, ata (shqiptarët, V.K.), do të zhyten në ujë dhe nuk do të munden të dalin më". Përmendën me respekt emrat: Abdi Mati, Dashamir Ohri, Skënder Doçi, Petrit Myftiu, Beqir Gërbi, Tahsim Meçe.....Kujtim Peçi, Fitim Halili... ish-kuadro drejtues të njësive të nëndetësëve dhe të Flotës sonë Detare. Në vazhdim ata folën më gjatë për Aleko Pojanin, që arriti të bëhej komandant nëndetëseje kur ishte vetëm 21 vjeç. Ai dhe ekuipazhi që drejtonte, kishin arritur të lundronin në thellësitë e Detit Mesdhe për 22 ditë rresht në vitin 1969, pa dalë fare në sipërfaqe... Në bisedën me ta, mësova se nëndetësja kishte 2 motor të fuqishëm diezel, shpejtësia arrinte 18 milje në orë, ishte e armatosur me 12 silurë dhe një sasi minash që vendoseshin në fundin e detit. Biseda e oficerëve që qëndronin me mua shkoi te avaritë e mundshme dhe situatat e vështira që krijoheshin ndonjëherë gjatë lundrimit me nëndetëse. Oficerët, herë njëri dhe herë tjetri, më

shpjegonin se sa e rrezikshme ishte kur nëndetësja merr diferent, domethënë nga lundrimi horizontal, për shkak të ndonjë veprimi të gabuar, kalonte papritmas në një pozicion pjerrësie, që e shpie nëndetësen me shpejtësi drejt fundit të detit. Raste të përafërta, ata i kishin përballuar me guxim e gjakftohtësi, duke shpëtuar ekuipazhin me mbi 80 marinarë e oficerë, por edhe mjetin luftarak, i cili konsiderohej tepër i rëndësishëm. Asokohe Shqipëria kishte vetëm 4 nëndetëse, nga 12 që kishim kur Baza Ushtarake e Vlorës funksiononte si bazë ushtarake e Traktatit të Varshavës.

Kontrolli i diezelëve përfundoi. U dhanë komanda të tjera dhe nëndetësja nisi të lëviz nën ujë.

- Për pak çaste do të lundrojmë në thellësinë e periskopit, - tha komandanti i nëndetësës dhe, ndërkaq u afroam te periskopi. Ai më ftoi që të shihja nëpërmjet periskopit sipërfaqen e detit të Gjirit të Vlorës. Ishte një çast mbresëlënës vështrimi i sipërfaqes së detit nga thellësia prej 9 metër nën ujë. Nëndetësja vijoi të lundronte edhe disa qindra metra nën ujë pastaj u dhanë komanda të tjera dhe gjiganti 650 tonësh u ngrit në sipërfaqe.

- Tani do të lundrojmë si një anije mbiujësë, - tha komandanti dhe më ftoi të dlinim jashtë, në bordin e nëndetësës. Kapaku u hap dhe shpejt u gjendëm në kullën e nëndetësës. Një rrymë ajri i





më ngjasojnë me “balena” me lëkurë të çeliktë që nuk marin më frymë, se, e kanë mbaruar jetën e tyre. Por, secila nga ato nëndetëse përmban brenda saj vlera të objekteve muze, sepse ato të kujtojnë sakrificat të panumërta të detarëve që i kanë drejtuar dhe komanduar me guxim, siguri, emocion dhe luftë nervash. Disa prej oficerëve të nëndetëseve ose edhe oficerë të tjerë të flotës, të aviacionit, detarisë dhe ushtrisë, ndodh që i takoj edhe sot në rrugë dhe në mjedise të ndryshme, në punët dhe hallet e tyre. Koha ka bërë të vetën. Dikush prej tyre mbahet mirë, dikush edhe shkruan kujtimet e jetës dhe të sakrificave që ka kaluar së bashku me kolegët... I shoh dhe ndjej dëshirën t'i ftoj për kafe, të bisedoj me ta, t'i dëgjoj me vëmendje tregimet e tyre. Disa flasin e tregojnë me pasion për detyrat që kryenin, për sakrificat që u janë dashur të bënin dikur. Dikush përmend edhe fjalët që kamerieri shqiptar i një lokali të bazës, në një debat, i tha oficerit rus të një nëndetëseje: “Zot, këtu jam unë, dhe jo ti!”.



në një takim shkrimtarësh. Ndër të tjera, vizitova edhe Muzeun Detar të Goteborgut. Një muze detar me hapësira të paana, me anije të shumta që pluskonin qetësisht në ujë. Ishin anije gjithfarë llojesh, nga më të vjetrat dhe nga më modernet, anije viking, anije me vela, anije peshkimi, anije luftarake, anije që përdorshin për zbulime shkencore, anije me motor, me aparatura drejtimi elektronike, deri edhe anije që lundronin me energji eolite (energji që prodhohet me anë të erës, për të kufizuar pasojat e ngrohjes globale)... Të tëra ekspozoheshin me madhësi, teksa në hapësirën e atij Muzeu Detar Gjigant, ndër 20 muzetë më të mëdhenj të botës, në bankina dhe nëpër anije lëvtrin, si çdo ditë, dhjetëra mijëra njerëz, turistë, vizitorë, ardhur nga të tërë anët e botës, për të njohur dhe për të respektuar historinë e atij vendi, të kaluarën, kulturën, zhvillimet, por edhe të nderonin ata mi-

freskët na rrahu fytyrat. Nga veri-lindja qyteti i Vlorës dhe kodrat pas saj, ndërsa në jug-perëndim Karaburunit dhe më tej Sazani krijonin një kurorë natyrore gjigante duke i dhënë gjirit një pamje sa mahnitëse aq edhe të rëndë. Këtë ndjesi e përjeton më shumë mbi kullën e një nëndetëseje, por ky fat të qëllon rrallë, shumë rrallë. Kur nëndetësja lundron mbi ujë të shkakton një kënaqësi të veçantë. Ajo ngjason me një superbalenë e zhytur pjesërisht nën ujë. Në të vërtetë, me madhësinë dhe gjatësinë që ka, nëndetësja ngjason më shumë me një përbindësh të çeliktë. Një dinosaur, përpara saj, do të ishte si një lodër fëmijësh. Gjithsesi, të lundrosh me nëndetëse në sipërfaqen e detit është vërtetë këndshëm dhe bukur. Në kullën e saj ndjen ajrin e shëndetshëm të detit, sheh peizazhe të mrekullueshëm, sidomos kur ajo lundron pranë brigjeve. Kurse, në det të hapur dhe, aq më tepër në thellësitë e oqeanëve, nuk është kaq bukur sa po shprehem. Prandaj, detarët kanë një fjalë të mençur: “Deti është i bukur, por nga bregu”. E, megjithatë, - po thosha me vete, - gjithkujt që i jepet mundësia, duhet të përjetojë ndonjëherë përvoja të tilla, sepse kështu arrin të vlerësojë më mirë edhe njerëzit rreth e përçark, detyrat që ata kryejnë, rreziqet që përballojnë. Ata detarë, oficerë të flotës dhe të mjeteve nënujësore e mbiujësore, jetonin dhe përballëshin përditë me rrezikun.

kur i takon këta njerëz, në pamjen e parë, nuk kanë asgjë të jashtëzakonshme. Ajo që mbetet e jashtëzakonshme, ka qenë vetë jeta e tyre, përballimi i vështirësive, privacionet që kanë provuar në jetë... Gjithnjë, vetëm me një lajtmotiv madhor: kurdoherë ushtarë dhe bijë të denjë të atdheut, të Shqipërisë.

**Në vend të epilogut**

I shoh sot nëndetëset e ish-bazës së Pashalimanit të fotografuara ose të filmuara në faqet e internetit. Ashtu, të plakura e të ndryshkura, qëndrojnë gjysmë të zhytura në ujë, pranë njëra-tjetrës, si relikte të një kohe të shkuar, madje nganjëherë

Ka edhe nga ata oficerë e detarë, që i mbulon tisi i heshtjes. Mbase, sepse ato sakrificat të mëdha dhe ai tensionim i jetës së tyre, atëherë nuk ishte gjithnjë i nevojshëm, mbase... Gjithsesi, ata njerëz meritojnë respektin e shoqërisë dhe vlerësimin. Ata ishin dhe mbeten ushtarë besnikë të Shqipërisë...

Kohë më parë kisha dëgjuar lajme se nëndetëset e Bazës së Pashalimanit i kanë çuar ose do t'i çojnë si skrap në uzinën e shkrirjes në Elbasan. Në fillim nuk i besoja, madje më dukeshin të sajura dhe dashakeqase. Por... Shtator i vitit 2011. Dhjetëra kamionë të ngarkuar rëndë përshkuan ditë të tëra njëzëri nga rrugët kryesore të qytetit të Vlorës.

B a n - orët dukeshin disi të hapur dhe kureshtarë të dinin se çfarë transportonin ata kamionë, që udhëtonin aq zhurmshëm. Përgjigja erdhi shpejtë. Ngarkesa e tyre ishin “trupat” e sharruar të tri nëndetëseve, të cilat, me atë autokolonë mortore, po i çonin në furra e shkrirjes në Elbasan. “Krenaria” e Flotës Luftarake Shqiptare gjatë “Luftës së Ftohtë”, po përfundonte në “kremator” (furnnaltë)... E bashkë me ato copëra çeliku dhe bakri, m'u bë se po përfundonin në furnnaltën e zjarrtë edhe tërë ato ngjarje, ndodhi, episode, marrëdhënie dhe histori njerëzish që kishin ëndërruar, kishin sakrifikuar... Në vitin 2013, isha i ftuar në Suedi

jëra jetë njerëzish që kishin jetuar, punuar dhe ëndërruar në atë pjesë të globit... Aty ishte dhe është historia detare e një populli të kulturuar dhe fisnik, që meriton respekt për veprat në dobi të jetës dhe zhvillimit.

Ndonëse disi të vonuar, le ta fillojmë edhe ne krijimin e këtij Muzeu Detar, si fillim me nëndetësen 196, apo e cilësuar artistikisht “Nëndetësja 105”. Sigurisht, nëse “dikujt” nuk i ka shkuar apo nuk i shkon mendja që të jap komandën arrogante dhe të dhimbshme: - “Nëndetësja 105!”, “Nëndetësja 105! Më dëgjon? Me të tërë fuqinë e motorëve: përpara, drejt... furnnaltës...!”. Jo, kjo do të ishte marrëzia e fundit dhe që nuk duhet të ndodh kurrë.

**NJOFTIM**

*Për kriteret e përgjithshme për rekrutimin e ushtarëve /detarëve aktiv në FA*

- a) Për t'u rekrutuar në Forcat e Armatosura si ushtar/detar aktiv shtetasit shqiptarë duhet të plotësojnë kriteret e mëposhtme:
    - Të jetë shtetas shqiptar.
    - Të mos jetë dënues nga gjykata për vepra penale.
    - Të mos jetë në ndjekje penale.
    - Të mos ketë humbur të drejtën e ushtrimit të profesionit ose vepërimitarisë në administratën publike me vendim gjykate.
    - Të mos jetë në proces gjykimi penal nga Gjykata
    - Moshë minimale e rekrutimit është 18 vjeç. Në momentin e titullimit ushtar/detar aktiv, nuk duhet të kenë mbushur moshën 27 vjeç.
    - Përfundimisht bëjnë vetëm shtetasit që do të titullohen ushtar/detar aktiv, të cilët do të jenë personel mjekësor i Forcave të Armatosura dhe në momentin e titullimit nuk duhet të kenë mbushur moshën 32 vjeç
    - Të ketë kryer arsimin parauniversitar ose të lartë brenda ose jashtë vendit.
    - Të ketë kryer kontrollin shëndetësor dhe të jetë vlerësuar i aftë për ushtar/detar aktiv nga Spitali Ushtarak i Komandën Mbështetëse.
    - Të ketë kaluar testin, fizik, intelektual dhe psikologjik.
    - Kandidatët për ushtar/detarë aktiv të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe mbi 165 cm për femrat.
    - Kandidatët për ushtar aktiv, të planifikuar për kompletimin e Policisë Ushtarake, duhet të kenë gjatësinë trupore mbi 170 cm për meshkujt dhe femra.
  - b) Për rekrutimin sipas specialiteteve të veçanta, veç këtyre kriterëve të aplikohen edhe kriteret specifike për aftësitë profesionale dhe parametrat fizikë, të cilat përcaktohen me një udhëzim të veçantë të SHSHP.
- Procedura e aplikimit për ushtar/detar aktiv.**
- a) Shtetasit që dëshirojnë të shërbejnë në Forcat e Armatosura si ushtar/detarë aktiv, do të aplikojnë drejtpërdrejtë në zyrën e pranimit në Qendrën e Personel Rekrutimit.
  - b) Aplikantët plotësojnë formularin e aplikimit dhe pranimit të do-

- kumentacionit dhe marrin njoftimin për dokumentet e nevojshme, afatin e paraqitjes në Qendrën e Personel Rekrutimit për vijimin e procesit të pranimit, testimit e përzgjedhjes.
  - c) Procedurat, kriteret, rregullat e testimit bëhen publike në faqen e internetit të Forcave të Armatosura.
- Regjistrimi i kandidatëve dhe dokumentacioni i nevojshëm
- a) Kandidatët për ushtar/detar aktiv, paraqesin në Qendrën e Personel Rekrutimit, dokumentet e mëposhtme:
    - Kërkesë me shkrim, në të cilën paraqet identitetin e aplikantit, statusin familjar (martuar, beqar), arsyet për të cilat dëshiron të bëhet ushtar/detar aktiv, njësia apo reparti në të cilin do të dëshirojë të shërbyer. Aftësitë, përvoja në punë, prirjet e tij në fusha të caktuara.
    - Fotokopjen e kartës së identitetit
    - Certifikatë familjare.
    - Dy fotografi të përmasave 4 x 6cm dhe dy fotografi të përmasave 9x12 cm
    - Fotokopje të diplomës së arsimit parauniversitar ose të arsimit të lartë të noterizuar dhe të vërtetuar nga Drejtoria Arsimore Rajonale/Rrethit.
    - Diplomë, dëshmi, certifikatë për aftësitë profesionale (nëse ka), të noterizuar.
    - Dëshmi penaliteti.
    - Vërtetim nga prokuroria.
    - Vërtetim nga gjykata.
    - Fletë të ekzaminimit mjekësor nga Spitali Ushtarak i Forcave të Armatosura në Komandën Mbështetëse.
- Periodha e regjistrimit të kandidatëve deri më 25 shkurt 2016.
- Adresa:**  
**Qendra e Personel Rekrutimit, Rruga e “Dibrës” (Ish-Shkolla e Bashkuar), Tiranë**  
**Kontakt: ++ 355 42 34 85 88**

Kam lexuar jo mjaft shkrime dhe kujtime të mrekullueshme për sakrificat e panumërta të detarëve, oficerëve, nënofficerëve dhe të gjithë ushtarakëve, që shërbejnë me devotshmëri të lartë në reparte e pika të vështira, larg familjeve të tyre dhe zonave të banuara dhe që në krye të detyrave kanë dhënë edhe jetën në shërbim të interesave të atdheut. Edhe në Njësinë e Nëndetësve, që ishte një njësi elitare e ushtrisë dhe në Flotën Luftarake Detare ka ushtarakë që kanë rënë në krye të detyrës, që janë dëshmorë dhe heronj, siç është Heroi i Popullit Spiro Kote. Shumë dëshmorë dhe heronj ka edhe Aviacioni dhe e gjithë Ushtria Shqiptare, për të cilët do të duhej të shkruheshin libra të tërë, sepse kanë qenë ushtarë besnik për mbrojtjen detare, ajrore dhe tokësore të atdheut tonë. Të tillë ishin edhe detarët me të cilët pata fatin të lundroja nën ujë me atë nëndetëse vite më parë. Edhe sot,

Flet kolonel (R) Qatip Aliaj, ish-ushtarak me një karrierë të gjatë dhe të suksesshme në FA

# Dëshiroj që edhe nga fëmijët e fëmijëve të mi të kishte një brez ushtarakësh

Intrvisti: MUHARREM DARDHA  
ALBERT Z. ZHOLI

**Q**atip Aliaj është me origjinë nga Vlora, por fëmijërinë e ka kaluar në Elbasan, qytet për të cilin ruan ende kujtime të bukura. Arsimin 7-vjeçar e ka bërë në shkollën "Naim Frashëri", një nga shkollat elitë të qytetit. Ishte fundi i viteve 1950 kur të ardhurit në Elbasan ishin të pakët në numër. Elbasani ishte dhe është një qytet me kulturë, me njerëz të qytetëruar, që i respektonin, i përkrahnin dhe i pranonin me dashamirësi ata. Me këtë kulturë dhe në këtë mjedis u rrit Qatipi. Më pas iu përkushtua arsimimit dhe karrierës ushtarake, duke arritur deri në detyrën e lartë të zv.shefit të Shtabit të Përgjithshëm dhe drejtor i Drejtorisë Operative në Ministrinë e Mbrojtjes...

**A e kishit menduar atëherë se një ditë do të bëheshit oficer?**

Jo, isha fëmijë, isha ngacmuar nga uniforma "gjeneral" e skënderbegasve, por asnjëherë nuk e kisha menduar se një ditë do të bëhesha oficer. Ishte zgjedhja e prindërve që në vitin shkollor 1960-1961 unë të nisja studimet në shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej". Shumë shpejt rashë në sy për rezultate të larta në mësim, por si unë ishin edhe shumë shokë të tjerë. Shkolla "Skënderbej" ishte një gjimnaz i pastër. Ne kishim vetëm uniformën dhe rregullin ditor si ndryshim nga gjimnazet e tjera; ndërsa kurikula mësimore ishte e njëjtë. Kujtoj gjithashtu se me mbarrimin e shkollës së mesme "Skënderbej" ne nuk dinim që në shkollën e lartë ushtarake, pra në Shkollën e Bashkuar formimi bëhej me specialitete; ne dënim thjesht se do bëheshim oficerë. Kur komandanti i kompanisë, Hasan Gjata, një komandat brezash atje, shkroi në dërrasën e zezë emërtimin e specialiteteve që përgatiteshin në Shkollën e Lartë u befasuam. Unë dhe një nga shokët e mi më të mirë, vendosëm të zgjidhnim në të tri alternativat këmbësorinë si specialitet. Pra, u regjistruam në Shkollën e Lartë të Oficerëve për këmbësori. Ne ishim matura e viti 1964, një nga më të mirat e të gjithë kohërave në atë shkollë. Si bashkëmohatarët kam lexuar: Kronin, Remarkun, Stendalin, Xhek London, Floberin; kam regjistruar në mëndje vargje të Esenin, kam admiruar Lame Kodrën; kam adhuruar I. Kadaren, Vaçe Zelën, Panajot Panon, Agim Fagun...

**Pra, filluat Shkollën e Lartë të Oficerëve për këmbësori?**

Po. Ishte shtatori i vitit 1964. Në shkollë u dashurova me specialitetin dhe në përfundim të studimeve dola me rezultate shumë të mira. Këtë në radhë të parë unë dhe shokët ia u dedikojmë



trupës së shkëlqyer të pedagogëve të asaj shkolle.

**Pas përfundimit të Shkollës ku ju emëruan?**

Ishte viti 1967. Më emëruan pedagog aty në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve, në Katedrën e Taktikës, praktikë që më parë për emërimin në këtë detyra, pa një lloji përvojë shërbimi në trupa, nuk qe aplikuar. Ndoshta se, ndërkohë, një vit më parë ishin hequr edhe gradat ushtarake. Në këtë kohë në botë ndodhën ngjarje tronditëse ushtarake si në Çeki, Izrael etj., çka për ne ushtarakët do të thoshte gatishmëri. Në shkollë gjeta një mjedis të mrekullueshëm pune. Veç drejtuesve gjeta kolegë që më kanë frymëzuar dhe më kanë nxitur në karrierën time të mëpastajme ushtarake.

**Kush ishin disa prej atyre që iu frymëzuan dhe cilët ishin disa nga shokët që më vonë bënë emër në ushtri?**

Së pari, do të kujtoja komandantin e Shkollës, kolonel Enver Begeja, një model imitimi për shumë breza oficerësh të rinj, shembull i drejtuesit të talentuar. Në raport me të, të gjithë ishim njolloj të baraslarguar dhe po kështu, pavarësisht shkallës hierarkike, të gjithë ndiheshin njolloj të afërt me të. Ai nuk e njihte padrejtësinë. Po i tillë ka mbetur për mua edhe Mina Mishaxhiu, apo pedagogu "i lindur", shefi i katedrës sime Ebehë Gorishti. Për shans mua më takoi të jem bashkëkohës i një grupi oficerësh të talentuar, mësimdhënës shumë të mirë si: Nevruz Sako, Kostaq Karoli, Veri Koçi, Flamur Islami etj, që kanë bërë emër për profesionalizmin e tyre në ushtri.

**Sa kohë qëndrove petagog në këtë Shkollë?**

Qëndrova deri në vitin 1970 dhe

si vend kufitar. Gjeta aty një kontingjent ushtarak shumë të mirë nga Tirana, Saranda, Berati, Gjirokastra, Fieri, Vlora. Batalioni funksiononte edhe si shkollë nënoficerësh. Me ata djem krijova marrëdhënie të paharruara, disa prej tyre edhe sot i takoj me shumë përzemërsi. Pas më pak se një viti u lëvizta nga ajo detyrë dhe shkova komandant batalioni në Krumë. Kjo ishte një zonë akoma më e vështirë. Një repart me terren shumë të thyer, që mbulonte zonën Cahan, Pogaj, Kishaj ku kishim një kompani me efektiv aktiv, të cilëve iu duhej të përballeshin me një jetë tejet të vështirë dhe me shumë privacione. Mungesa më e madhe ishte e uji. Duhej të trajtoje 40-50 vetë me ujë, që sillej nga disa km. larg, me ushqim, ngrohje. Sot një sakrificë e tillë është e pa konceptueshme. Në atë zonë 3-4 muaj të vitit vendi është nën pushtetin e dëborës. Fshatrat e siguronin ujin nga puse, "bunarë", siç i quanin ata, ku ujërat mblidheshin gjatë dimrit prej reshjeve të dëborës e të shiut. Uji për të pirë mirej nga dy orë e gjysmë larg, me kafshë. Ishte vitit 1972. Këtu qëndrova afërsisht një vit. Kam qarkulluar shpejt në detyra...

**Pra, ende pa u ambientuar mirë këtu, ju transferuan sërish?**

Po, u emërova shef Operativ në shtabin e Brigadës në Kukës. Për fat komandant Brigade ishte Nuret Jaubelli, një drejtues i aftë, plot pasion e përkushtim. Të gjithë shefat në shtabin e Brigadës ishin mbi 40-vjeçar, me eksperiencë të gjatë, unë isha më i riu. Do doja të kujtoja Nebi Selimin, Haziz Bulicën, Pilo Qendron, Dashamir



Musajn, Ragip Zekën, Petrit Mamaj, Agron Pogën, Preng Kaçorrin, Naim Haxhiun, Mustafa Toçillën, Andrea Nitom etj, që ishin oficerë të zotë, por edhe njerëz me integritet. Pak kohë më vonë në detyrën e komandantit të Brigadës u emërua ish shefi i Shtabit, Binak Kortoçi, një djalë shumë punëtor, nga Tropoja.

**Gjatë kësaj kohe çfarë mund të veçoni?**

Do të veçoja çfarë përjetova gjatë punës për zbatimin e detyrës për të organizuar dhe vënë në efencë Qendrën e Stërvitjes në kantierin e ndërtimit të Hidrocentralit të Fierzës. Ishte viti 1974. Në atë kohë në Fierzë punonin rreth 12 mijë punëtorë e specialist. Ishte një kantier gjigand, që vështirë se mund të ripërsëritet, vështirë të përshkruhet. Një qytet i tërë, me njerëz heronj. Një qytet që gumëzhinte natë dhe ditë, që nuk kishte asnjë minutë qetësi. Aty kishte njerëz që vinin nga të gjithë rrethet e vendit: shkodran, tropojan, pukjan, kuksian, dibran; por kishte specialistë edhe nga Saranda, Berati, Durrësi, Gjirokastra, Vlora, Tirana, nga e gjithë Shqipëria. Pothuajse shumica ishin nën detyrimin e shërbimit ushtarak në rezervë dhe kishin transferuar kartelat ushtarake në Bajram Curri dhe aty





do ta bënin edhe stërvitjen ushtarake. Pra, do ndërtohej një praktikë ndryshe, ku për përballimin e kontingjentit disponibël do të kryhej stërvitje çdo ditë. Qendrën e Stërvitjes e çelëm në Dushaj, aty ku bashkohet Valbonën me Drinin. Në dispozicion të saj ishin një grup oficerësh të paemëruar në detyrë, por të komanduar vetëm për stërvitje. Çdo gjë shkoi mirë falë edhe mbështetjes së Drejtorit të Përgjithshëm të kantonit Muhedin Muço dhe të kryeinxhinierit Ismail Ahmeti, në zyrën e së cilit kam parë për herë të parë katalogë të makinerive të ndërtimit të kohës. Edhe aty në detyrë qëndrova rreth një vit.

#### Besoj se prapë emërim tjetër...?

Po. Në vitin 1975 u emërova shef Shtabi i Brigadës së porsakrijuar të Krumës, asokohe e vendosur në Helshan, në një vendkomandë nëntokësore brigade. Edhe këtu një situatë tjetër e vështirë. Pranë saj ishte qendra e zakonshme e fshatit, ku kishte një shkollë 8-vjeçare dhe një mensë shumë të vogël. Aty ne dhe disa mësues që vinin nga rrethet e tjera të largëta të vendit ushqeheshim si mundnim. Kur thuajse njësisia ishte organizuar u largova për studime në Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm. Ishte vitit 1977. Pas përfundimit të studimeve akademike dy vjeçare, në vitin 1979 më mbajtën aty pedagog.

#### Çfarë do të veçoje nga Akademia Ushtarake e Shtabit të Përgjithshëm?

Aso kohe Akademia e Shtabit të Përgjithshëm ishte institucioni më i rëndësishëm mësimor dhe shkencor i Ushtresë Shqiptare. Aty njoha pedagogë e punonjës të shkëlqyer shkencor, që kanë ndikuar më së shumti në rrugën time të gjatë e të vështirë si oficer karriere. Pata rastin të kisha shef katedre Moisi Elezin, por edhe të bashkëpunojta me një grup oficerësh në pension: ish pjesëmarrës dhe drejtues njësisish në LNÇI, që aktivizoheshin si pedagogë të jashtëm si Vehbi Hoxha, Thoma Xhixho, Bejto Isufi etj. Komandant i Akademisë ishte Spiro Adhami. Këta dhe të tjerë ishin nga ata që kishin mbaruar shkollën e mesme para luftës, pra para vitit 1944; zotëronin një kulturë të përgjithshme të admirueshme dhe ishin njohës të disa gjuhëve të huaja, që i dhanë një shtysë mendimit teorik ushtarak për kohën. Qëndrimi im aty përkoi edhe me rinovimin e trupës

mësimore me të tjerë të porsadiplomuar si: Kostaq Karoli, Ramadan Kamberi, Shamet Shabani, Xhevdet Taullai, Ruzhdi Gjatoja etj, të cilët bënë më vonë një karrierë të shkëlqyer në drejtimin e FA. Dhashë mësim me kurset e dyta ku jepeshin njohuri mësimore për artin operativ dhe strategjinë ushtarake, lëndë që më pëlqenin shumë. Materiali mësimor leksionet skenarët e lojërave luftarake dhe detyrat ushtrore përgatitshin nga trupa mësimdhënëse. Di që edhe sot në kurse akademike përdoren materiale të miat. Natyra e mësimin në Akademia kishte karakter të theksuar aplikativ ndaj kishte goxha ngarkesë në tavolinë për të mundësuar formimin e liderit të zot me aftësi e shprehje bashkëkohore. Tre vite më më vonë më caktuan në drejtimin e Katedrës Gjitharmëshe, një trupë solide në përbërje të së cilës ishin emra profesionistësh me karrierë të spikatur si: Shyqyri Kondi, Xhemil Çela, Shahin Leka, Pandi Dushku, Reiz Nika, etj, pedagogët e mi gjatë studimeve.

#### Deri kur qëndruat në Akademi, pasi shihet qartë që ishit oficer i qarkullimit të shpeshë?

Në Akademi qëndrova deri në shkurt të vitit 1983, kur FA kaluan nga struktura me Korpuse në Divizione. U transferova dhe u emërova për së dyti në very, në detyrën e shefit të Shtabit të Divizionit në Pukë. Këtu shërbeva dy vjet e gjysmë, deri në maji 1985. Divizioni shtrihej në rrethet Pukë, Has, Tropojë dhe pjesërisht në Shkodër. Komandant ishte Çelo Bora. Ndërtova marrëdhënie shumë të mira me shtabin që përbëhej nga oficerë me eksperiencë, shumica e së cilëve vinin nga ish-shtabi i Korpusit të Pukës. Këtu do të veçoja: Nebi Selimi, Fadil Nanaj, Sheme Shega, Ylli Kodra, Jorgo Imeri, Veli Vuka, Bajram Sinani, Fran Luli, dhe Sadush Hysi; si dhe komandantët e njësisive, Behar Xheka, Veri Koçi, Zaho Muça, Fejzo Haxhia e Gëzim Çela. Në maj 1985 përsëri në Tiranë, në Shkollën e Lartë të Oficerëve si shef i Katedrës së Taktikës. Aso kohe shkolla kishte kaluar në sistem 4-vjeçar. Tashmë dijet që jepeshin nuk ishin vetëm ushtarake. Ndërkohë ishte rritur numri i studentëve; vetëm këmbësoria kishte deri në 12 paralele për çdo vit akademik. Në përputhje me kurikulën e re, sipas së cilës jepeshin njohuri për Brigadën ripunoheshin tekstet dhe gjithë materialet e tjera mësimore, të cilat në dy vite i

kam redaktuar një e nga një. Bëhet fjalë për dhjetëra e dhjetëra materiale. Komandant i Shkollës ishte Arseni Stroka. Brezi i atëhershëm i studentëve është tani në majat e karrierës ushtarake. Të tjerë kanë bërë karrierë jashtë ushtresë, madje edhe në politikë, ndër ta është presidenti i Republikës Bujar Nishami, ka deputetë, zëvendësministra, kryetar bashkie etj.

Po më vonë si vijoi karriera juaj, përsëri me emërim në rritje?

Në vitin 1987 u emërova drejtor i Drejtorisë së Shkollave Ushtarake në Ministrinë e Mbrojtjes. Drejtoria ishte krijuar dy vjet më parë. Ende nuk kishte marrë formë të plotë si strukturë në MM. Misioni i saj ishte hartimi dhe zbatimi në sistem i politikës së arsimimit të Ministrisë së Mbrojtjes dhe udhëheqjes teknike të kurikulave dhe dokumenteve të tjera të shkollave, përfshi dhe edukimin ushtarak në shkollat mesme dhe të larta të vendit. Ajo mbante në lidhje me Akademinë e Shtabit të Përgjithshëm, Shkollën e Lartë të Oficerëve, shkollën e mesme ushtarake "Skënderbej"; tre shkolla të përgatitjes së oficerëve rezervistë, shtatë shkollat e kualifikimit të kuadrin rezervist. Drejtoria jonë ishte drejtoria e "bombarduar" nga kërkesat e panumërta të familjarëve që vinin nga fshati dhe qytetet e skajshme për të sjellë fëmijët në shkollat ushtarake. Shkollat tona, si e mesjma dhe e larta plotësoheshin kryesisht me fëmijë të këtyre shtresave. Vetëm për pranimit në shkollën e mesme "Skënderbej" kërkesat ishin të pafundme edhe pse numri i pranimeve vjetore shkonte deri edhe 400-450 vetë.

Besoj se kjo përvojë të shërbeu për detyrën tjetër të radhës?

Padyshim më shërbeu, më pas u emërova komandant i Frontit Bregdetar

në Shtabin e Përgjithshëm, nga e cila u lirova në dhjetor të vitit 2000, për tu rikthyer edhe një herë në shkollat ushtarake në drejtimin e një qendre studimore shkencore, deri sa dola në rezervë në gusht të vitit 2004. Më pas civil, si punonjës shkencor në Akademi, deri në ndërprerjen e mardhënieve në vitin 2006.

#### Kur i ke përjetuar momentet më të vështira në karrierën e gjatë si oficer?

Si periudhë më gjurmëlënësia në jetën time ushtarake do të doja të veçoja atë të viteve 1990-92 dhe 1997-99. Periudha e parë përkoi me situatën delikate të ndryshimit të sistemeve, ndërsa e dyta me masat për rikuperimin e dëmeve që i qenë shkaktuar ushtresë nga ngjarjet e vitit të mbrapshtë 1997 dhe angazhimin për përballimin e situatës së krizës së Kosovës. Në vitet 90-92 FA u gjendën në vështirësi të paprovuara më parë. Udhëheqja e kohës në panik për shkak të pushtetit që po humbiste, e keqpërdori ushtresë, e posaçërisht me angazhimin e saj në detyra policore e tej përgjegjësi kushtetuese të kohës; në mbrojtjen e objekteve jo ushtarake dhe në vendosjen e ruajtjen e rendit etj. E gjithë kjo e tronditi rëndë drejtimin e forcave ushtarake dhe u dëmtua kohezioni i radhëve. Duhet të keni parasysh që bëhet fjalë për një ushtri të madhe me 22 divizione, Forcat Detare, Forcat Ajrore dhe njësit e vartësisë së drejtpërdrejt me një personel prej rreth 96.000 vetë (ushtarak dhe civil). Vetëm trupa e oficerëve ishte rreth 16.200 vet. Por fal formimit qytetar të korpusit të oficerëve dhe trupës ushtarake në tërësi, emri i ushtresë nuk u bë pis...Në vitet 97-98, FA u gjendën njolloji në vështirësi, bile do të thoja në situatë edhe më të vështirë, por fal përkushtimit të trupës, thuaj se



dhe ndihmës Shef i Shtabit të Përgjithshëm. Sa për sqarim: pas krijimit të divizioneve u krijuan dhe tre Fronte: Fronti Bregdetar, Fronti Juglindor dhe Fronti Veriperëndimor. Në këtë detyrë kam punuar paralel me dy drejtues të talentuar: Ismail Shulkun dhe Perlat Sulën. Emërimi përkoi me momentin kur thuajse i gjithë ekipi drejtues i ushtresë, që nga shefi Shtabit të Përgjithshëm, iu la në dorë 40 vjeçarëve, që duke qenë më të mirsimuar e më me mëndjehapur, sollën një frymë të re në drejtim. Asnjëri prej nesh nuk u përfshi në forumet e larta të partisë shtet, siç kishte qenë praktika e deriatëhershme. Ne ishim të panjohur, ose për fat të mirë nuk e gëzonim besimin e "jerarkëve". Në vitin 1991, me ndryshimet politike në vend, kalova në detyrën e drejtorit të Drejtorisë Operacionale dhe zëvendës shef i Shtabit të Përgjithshëm. Në maj të vitit 1992, u lirova nga kjo detyrë dhe më nxorën në rezervë.

Në gusht 1997 u riktheva sërish në uniformë dhe përsëri në detyrën e drejtorit të Drejtorisë Operacionale

paralel, u përballuan njëherazi dy detyra të rëndësishme; vënia në kontroll e inventarit të pasurive ushtarake dhe përballimi në nivel i bashkëpunimit institucional me NATO-n i ndalur nga ngjarjet e atëhershme. Vetëm në gjysmën e dytë të vitit 1997 dhe në fillimvitin e vitit 1998 NATO ishte prezentë tek ne me katërmëdhjetë epike asistencë me afërsisht 256 vetë me qëllim orientimin e ndërprerë të punës të nisur të FA drejt anëtarësimit në NATO. Në rezultat të kësaj veprimtarie u rishikua tërësisht legjislacioni i fushës dhe u draftuan dokumentet kryesore për sigurinë e mbrojtjen. Por në fillim të vitit 1998, angazhimi më i rëndësishëm i kësaj periudhe padyshim ishin masat për përballimin e situatës së pritshme në Kosovë. Ne u përfshimë në projektin e komunitetit euroatlantik dhe përkatësisht të NATO-s, për gati një vit më parë, se sa ndërhyrja në terren, me zbarkimin në vendin tonë të stafit të gjeneral John Reith (Xhon Rit), në prill të vitit 1998. Gjeneral Xhon Rit me

një karrierë brilante në vendin e vet dhe në misionet të NATO-s, e njihje mirë Ballkanin sepse në momentin e shpërbërjes së ish-Jugosllavisë kishte shërbyer si komandant i Forcave Britanike në Kroaci, ndërsa në 1997 qe emëruar komandant i Komandës së Bashkuar të Forcave të Gatshme (të lëvizshme) të NATO-s, në Evropë. Nga pozicioni që mbante ai u delegua të projektonte në terren operacionin e ndërhyrjes së NATO-s në Kosovë, në krye të një ekipi të gjërë. Për shkak të detyrës që mbaja e bashkëshoqërova atë deri në përfundim të misionit të tij. Në analogji me përbërjen e grupit të tyre të gjerë edhe ne krijuam një ekip me oficerë të zgjedhur nga Shtabi i Përgjithshëm dhe nga njësi e reparte të tjera të FA. Nga prilli deri në qershor bëmë përmohjen e hapësirës veriperëndimore. Lëvizëm me helikopter në gjithë këtë zonë, verifikuam kapacitetet e aeroporteve e fushave të uljes, të rrugëve tokësore të furnizimit evakuimit. Në koherencë me parapërgatitjet e aleancës në fund të vitit 1998, duke kapërcyer shumë vështirësi, me mbështetjen prioritare të qeverisë dhe nën kujdesin e drejtpërdrejt të Kryeministrit Majko, edhe ne si palë u bëmë të gatshëm për të përmobur përgjegjësin tonë. U riorganizua Divizioni i Kukësit, në vëmendjen tonë ishin dhe divizionet e Burrelit dhe Shkodrës. Fal kësaj, ndërhyrja e NATO-s, na gjeti të përgatitur dhe ne bëmë një mbështetje serioze.

#### A i ndjek zhvillimet e sotme në ushtri?

Jo, thjeshtë kam një përjasje familjare. Shoqëria e ushtresë i ngjanë një lloji "vëllazërie" që respektohet si ndjenjë nga individët pjestarë të saj përjetë, por s'mjafton vetëm kaq, do të duhej të ruheshin edhe kontaktet fizike midis brezave. Për mendimin tim është detyrë e Ministrisë së Mbrojtjes në kuadër të detyrës funksionale, për përkujdesjen ndaj personelit ta bëjë këtë. Jo një herë kam pasur rastin të gjendem në vende të tjera në raste përkujtimore në njësi e reparte. Atje ishin të pranishëm jo vetëm ushtarakët në shërbim, por edhe ata, që në rezervë kishin dal nga ajo njësi. Ata trajtoheshin institucionalisht si pjesë asaj njësie, dhe kishin akses të njëjtë me ata në shërbim.

#### Po nga ministrat që ke punuar kë do veçoje?

Do të veçoj Luan Hajdaragën me të cilin pata rastin të punoja përgjatë zgjidhjes së krizës kosovare. Ishte menaxher i zoti, gjakftohtë, me një stil drejtimi të veçantë, ndoshta dhe për shkak të formimit të tij profesional. Njohësi i mirë i metodës së analizës, dëgjonte me durim. Ishte i sigurt në vendimmarrje.

#### Zoti Qatip, ju keni dy djem dhe të dy janë oficerë që shërbejnë në FA. Ka qenë kjo kërkesë e juaja apo dëshirë e tyre?

Djemtë e mi janë graduat të brezit të tretë në familje. Ndihej mirë edhe sepse kur kemi bashkë nga që edhe ime shoqe është punonjëse në një njësi ushtarake, shpesh në bisedat tona ushtria është temë, mbesat e mia bëjnë nderim ushtarak. Zgjodha unë, apo ishte dëshirë e tyre? Do të thosha ishte thjeshtë zgjedhja më e natyrshme. Të dy, Amanti dhe Joridi, ashtu sikundërse shokët e tyre, sot janë të përfshirë me sukses në karrierën e tyre. Por si brezi i ri, edhe ata kanë tashmë familjet e tyre të reja, ndaj si çdo prind do të doja që në familjet e tyre të kishte më shumë mirëqenie, por unë do të dëshiroja që edhe nga fëmijët e tyre të kishte një brez të katërt ushtarakësh.

# Në forcim të trajnimit për të drejtën humanitare ndërkombëtare

Konferenca e 32-të Ndërkombëtare e Kryqit të Kuq dhe Lëvizjes Gjysmëhëna e Kuqe

MIMOZA GOLIKJA

NATO mori pjesë për herë të parë, në cilësinë e vëzhguesit, në Konferencën e 32-të Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Lëvizjes Gjysmëhëna e Kuqe, që u zhvillua në Gjenevë, nga 8-11 dhjetor 2015. Konferenca solli së bashku Shtetet Palë të Konventës së Gjenevës, organizatat Lëvizja Gjysmëhëna e Kuqe dhe Kryqin e Kuq dhe partnerët. Që nga viti 2003, Konferenca Ndërkombëtare ka qenë një forum ndërkombëtar qendror për vlerësimin dhe avancimin e shtetit të së drejtës dhe fatkeqësive në mbarë botën.

Organizata u zotua formalisht të vazhdojë një dialog thelbësor me Komitetin Ndërkombëtar të Kryqit të Kuq (KNKK) për të identifikuar fushat ku trajnimi dhe edukimi i ofruar nga NATO për të drejtën ndërkombëtare humanitare, mund të rritet më tej në “promovimin e praktikave operacionale ushtarake që siguron qasje të sigurt për të dhe ofrimin e kujdesit shëndetësor”, në rishikimin e procedurave të planifikimit operativ dhe standardeve të



trajnimit etj.

Angazhimi i NATO-s do të përfshijë masat për të mbrojtur civilët e prekur nga konflikti i armatosur duke vepruar në përputhje me rregullat dhe parimet e të drejtës ndërkombëtare humanitare,

njohjen respektimin për mandatin dhe misionin e KNKK-së, përpjekjet e vazhdueshme të NATO-s për të adresuar çështje të tilla si fëmijët dhe konfliktet e armatosura, të lidhura me konfliktin dhunën seksuale dhe gjinore, Programin Gratë, Paqja

dhe Siguria, Reduktimi dhe zbutja e viktimave civile.

## Vuajtjet njerëzore të konflikteve të sotme

“Ne kemi hyrë në një epokë në të cilën konfliktet e armatosura janë më të mëdha në kompleksitet dhe në numrin e aktorëve, më shumë në kohëzgjatje, më të gjera në ndikimin e tyre rajonal, më të gjera në taktikat dhe armët e përdorura dhe, mbi të gjitha, më mizore në vuajtjet njerëzore që ato shkaktojnë”, u shpreh Presidenti ICRC (KNKK), Peter Maurer në fjalimin e tij të hapjes. Konferenca, e cila mbledhet çdo katër vjet, është organi më i lartë vendimor i Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Ajo “debaton për çështje humanitare dhe miraton rezoluta që udhëheqin pjesëmarrësit e saj në kryerjen e aktiviteteve humanitare. Ajo nxit respektin për, dhe kontribuon në zhvillimin e të drejtës ndërkombëtare humanitare”. Pjesëmarrësit përfshijnë mbi 180 shoqëri kombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe dhe më shumë se 190 shtete që janë palë në Konventat e Gjenevës, vëzhgues nga organizatat tjera humanitare dhe organizatat ndërkombëtare.


## Dialogu i NATO-s me KNKK (ICRC)

Dialogu demonstroi përkrahjen gjithëpërfshirëse të aleancës për parimet e së drejtës ndërkombëtare humanitare dhe angazhimin e saj me komunitetin ndërkombëtar për të promovuar këto parime në praktikë. NATO është e angazhuar që të përfshijë masat për të mbrojtur civilët e prekur nga konflikti i armatosur në doktrinën ushtarake të aleancës, arsimim, trajnim, planifikim, ushtrime dhe kryerjen e operacioneve. Ky është shembulli i fundit i trendit pozitiv në dialogun ndërmjet NATO-s dhe KNKK-së, e cila ka fituar energji që prej nënshkrimit të një Memorandumi të përditësuar të Mirëkuptimit në mes KNKK, Komandës së Forcave Aleate për Operacionet dhe Komandës Aleate të Transformimit, në qershor të vitit 2012. Ky memorandum parashikon thellim të një dialogu të tillë për çështjet humanitare në operacionet, trajnime dhe ushtrime, si dhe në mësimet e nxjerra. Marrëdhëniet NATO-s me KNKK-në përfshijnë angazhime dhe shkëmbime të rregullta të nivelit të stafit të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe Presidentit të KNKK-së.

## Nga Turqia rurale drejt ceremonisë së Çmimit Nobel në Stokholm

NATO në mbështetje të studiuësve fitues të Çmimit Nobel në Kimi

Profesor Aziz Sancar, pas një udhëtimi dhe studimi dhjetëra vjeçar në botën e shkencës, mbriti nga provinca e qetë, rurale e Turqisë drejt ceremonisë së Çmimit Nobel në Stokholm. Që në moshë të re, Sancar bëri një zgjedhje që pothuaj të gjithë jetën e tij, ia kushtoi studimeve mjekësore dhe sidomos atyre në fushën e zbulimit të mënyrave për shërimin e sëmundjeve të rënda, tilla si kanceri i lëkurës etj. Çmimi Nobel 2015 në Kimi, nderon zbulimet shkencore të Sancar dhe dy kolegëve të tij, Tomas Lindahl dhe Paul Modrich, për studimet e tyre të riparimit të ADN-së. Kontributi i Prof. Sancar qëndron në “hartën e mekanizmit” që qelizat përdorin për të riparuar dëmin UV të ADN-së. Zbulimi i tij, ka dhënë një shpjegim më të mirë se si organet tona rregullojnë mutacione të ADN-së që mund të jenë shkaku i sëmundjeve të rënda si dhe të plakjes. “Hulumtimi themelor i kryer në 2015 nga laureatë të çmimit Nobel në kimi, ka thelluar jo vetëm njohuritë tona se si ne të funksionojmë, por mund të çojë në zhvillimin e trajnimeve të shpëtimit të jetës”, u tha nga komiteti Nobel, duke shtuar se “Vepra e tyre sistematike ka dhënë një kontribut vendimtar për të kuptuar se si funksionon qeliza jetësore, si dhe ofrimin e njohurive për shkaqet molekulare të disa sëmundjeve të trashëguara dhe për mekanizmat në zhvillimin e kancerit dhe të plakjes”. NATO ka kontribuar në këtë arritje shkencore, duke ofruar disa grante për Prof. Sancar gjatë gjithë karrierës së tij në vitet 1971-1973 dhe dy granteve të tjera në hulumtime bashkëpunuese, një në vitin 1986 dhe tjetri në vitin 1990.



### Diçka rreth Profesor Sancar

Profesor Aziz Sancar, i lindur në vitin 1946, u rrit në provincën Mardin, në juglindje të Turqisë, i shtati prej tetë vëllezërve dhe motrave në një familje më të ulët se sa klasa e mesme. Prindërit e tij ishin analfabetë, por i kushtuan rëndësi të madhe edukimit të fëmijëve të tyre. Që në moshë të re ai u përball me zgjedhjes së ëndërrës të fëmijërisë për tu bërë futbollist, pasi ekipi kombëtar i të rinjve i Turqisë i kërkoi atij që të bëhej portier dhe botës akademike. Ai zgjo-

dhi këtë të fundit. Sancar u laureua dhe ishte në krye të klasës së tij në mes të më shumë se 600 studentëve të Shkollës Mjekësore të Stambollit në vitin 1969. Më vonë punoi si mjek në provincën e tij. Në janar të vitit 1971, iu dha një bursë PhD nga Këshilli Shkencor dhe Teknologjik i Kërkimeve TUBITAK i Turqisë përmes Programit Felloëship të Shkencës të NATO-s. Ky grant e ndihmoi Sancar për të shkuar në Shtetet e Bashkuara në vitin 1973, ku studioi biologji molekulare dhe përfundoi Ph.D.

në Universiteti i Teksasit në vitin 1977. Pas diplomimit të tij, atij nuk iu dha një pozicion postdoktoral, prandaj Sancar punoi në laboratorin e Universitetit të Mjekësisë, një nga qendrat kryesore për hulumtimin dhe riparimin ADN-së. Sancar pranoi ofertën për t'u bashkuar me Universitetin e “North Carolina School of Medicine, Chapel Hill”, si profesor i asociuar i Biokimisë në vitin 1982, ku ai pati mundësi të tjera studimi për “riparimin e ADN-së”.

### Mbështetja e NATO-s

Në shkurt të vitit 1986, Profesor Sancar dhe Dr. Paul Heelis (North Instituti Eales East, Britania e Madhe), për kërkimet në bashkëpunim, morrën një grant nga NATO në mbështetje të tyre për t'u angazhuar në një projekt kërkimor shumë-vjeçar me titull “Studimet fotokimikë të mekanizmit të ADN-së”. Granti gjithashtu mundësoi Prof. Sancar të vizitonte kolegun e tij disa herë në Mbretërinë e Bashkuar për të kryer eksperimente së bashku. Në një raport të dorëzuar NATO-s në nëntor 1986, ekipi hulumtues parashikonte hetimin e “mekanizmave të riparimit të ADN-së nga enzima plotësisht të reduktuara” duke përdorur flash fotolizën. Raporti përfundimtar i grantit

të NATO-s vuri në dukje se “është bërë progres i konsiderueshëm për të kuptuar mekanizmin e riparimit të ADN-së” gjatë projektit. Në vitin 1990, Prof. Sancar dhe Dr. Heelis aplikuan me sukses për një tjetër Grant bashkëpunues të NATO-s në kërkimet me temë “Riparimi Fotoenzimik i ADN-UV-të dëmtuara”. Kjo lejoi ekipin për të vazhduar punën e tij në gjysmën e parë të viteve 1990 në këtë temë përfundimisht fitues i çmimit Nobel.

### NATO, të tjerë fitues të çmimit Nobel

Programi i NATO-s për shkencën paqen dhe sigurinë (SPS) ka një histori të gjatë të përfituesve të suksesshëm dhe ka mbështetur hulumtime të shumta të fituesve të Çmimit Nobel gjatë dekadave të fundit. Në vitet 1990, një total prej nëntë studiuësish, të cilët kishin përfutur nga grantet e NATO-s, morën një çmim Nobel në fushën e fizikës apo kimisë. Në të njëjtën kohë, hulumtues të shkëlqyer kanë ndihmuar Programin e Shkencës të NATO-s që nga fillimi i tij. Për shembull, Norman Ramsey, kryetari i parë i Komitetit të Shkencës të NATO-s (themeluar në vitin 1958), mori çmimin Nobel për Fizikë në vitin 1989. Fitues të Çmimit Nobel kanë marrë pjesë edhe në workshop-et e financuara nga NATO, përfshirë tetë laureatët e shquar që morën pjesë në zbulimet në Fizikës në vitin 1994 dhe, më së fundi, fituesi i vitit 1985 i Çmimit Nobel në Fizikë, Klaus von Klitzing që shte në një “Workshop Research SPS”, i avancuar në aplikimet e sigurisë të nanoteknologjisë në gusht-shtator 2015 në Odessa, Ukrainë.

# Brigada IV Sulmuese me një kontribut të çmuar për çlirimim e vendit



Prof. Asoc. DR. BERNARD ZOTAJ

Në fundin e vitit 1943 dhe fillimin e vitit 1944, Lufta Nacionalçlirimtare këndër pushtuesit nazifashist kishte marrë përpjesime të mëdha në të gjitha krahinat e vendit. Për t'a goditur më me efektivitet armikun, kishte lindur nevoja për krijimin e njësisë të mëdha luftarake. Me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, më 28 dhjetor 1943, në Voskopojë të Korçës, vend me tradita patriotike e kulturore, u formua Brigada e IV Sulmuese (Br. IV S). Në këtë brigadë u inkuadruan partizanë dhe kuadro me shumë përvojë luftarake të fituara në luftimet me armikun. Të tillë ishin luftëtarët e batalioneve partizane "Shqiponja", "Gor-Opar", "Tomori", "Çlirimi", "Fuat Babani", "Hakmarrja", si dhe një numër i madh vullnetarësh dhe kuadrosh nga qyteti i Korçës. Brigada u organizua me katër batalione dhe në ditën e inaugurimit u përbë nga një efektiv prej 600 luftëtarësh. Shumë shpejt gjatë luftimeve me armikun, ajo u dyfishua me partizanë vullnetarë të krahinave të Shqipërisë së Mesme.

Me Urdhër të Shtabit të Përgjithshëm, komandant i brigadës u caktua Nexhip Vinçani dhe komisar Pëllumb Dishnica. Të dy këta kuadro ishin me përvojë luftarake, të sprovuar në luftimet këndër armikut në qarkun e Korçës, patriotë dhe revolucionarë të brumosur me ndjenja patriotike për çlirimim e vendit. Ndërsa në shtabin e brigadës dhe në komandat e batalioneve u caktuan dhe shumë kuadro të dalluar në aksione dhe luftime të çetave partizane të qarkut të Korçës. Të tillë ishin Vaskë Gjino, Petrit Dume, Spiro Shalësi, Pano Xhamballa, Zija Kambo, Gafur Çuçi, Xhafer Lubonja, Gaqo Peristeri, Vera Pojani, Eleni Pashko, Fatmir Glata, Raqi Qirinxhi, Milo Qirko, Sotir Filto, Halit Mati etj., të cilët kishin përvojë dhe aftësi luftarake të shqura në luftime me armikun. Të gjithë këta kuadro dhënë një kontribut të madh në të gjitha luftimet e brigadës që nga krijimi e deri në çlirimim e vendit.

Armiku u trondit dhe u alarmua shumë nga krijimi i Br. IV S në qarkun e Korçës, por dhe nga aksionet e befasishme dhe të vazhdueshme të çetave dhe batalioneve partizane, të cilat me luftimet goditëse ishin bërë pengesë e madhe për lëvizjen e forcave gjermane nga Korça për në Greqi dhe në Jugosllavi. Gjermanët, me qëllim për t'i



shpartalluar ato, me forcat e Divizionit 100 të dislokuar në qarkun e Korçës, me një efektiv prej 900 oficerë dhe ushtarë, si dhe me rreth 1000 ballist dhe forca të tjera armike nga Berati dhe Elbasani, ndërmorën dy operacione të mëdha të Dimrit 1943 dhe të Qershorit 1944. Por me gjithë dëmet e mëdha që shkaktoi armiku me këto operacione, në të gjitha krahinat e qarkut të Korçës, duke djegur dhe masakruar shumë fshatra, nuk ia arriti qëllimit për t'i shpartalluar forcat partizane. Në këtë situatë të vështirë, batalionet territoriale dhe forcat e Br. IV S, falë drejtimit të përsosur të komandantit të saj, Nexhip Vinçani, heroizmit të partizanëve dhe mbështetjes masive të popullit të krahinës së Korçës, jo vetëm përballuan me sukses mësymjen e armikut dhe i shpëtuan rrethimit në këto dy operacione të mëdha, por e detyruan armikun të tërhiqej, duke pësuar humbje të mëdha në njerëz dhe teknikë luftarake. Pas kësaj disfate që pësuan gjermanët në këto dy operacione, Br. IV S dhe batalionet territoriale, me goditje dhe luftime të vazhdueshme ndaj armikut, çliruan të gjitha krahinat e pushtuara nga gjermanët në qarkun e Korçës, si dhe të Gor-Oparit, Kolonjës, Mokrës, Pojanit, Devollit etj.

Pas luftimeve të suksesshme kundër pushtuesve gjermanë në Operacionet e Dimrit dhe Qershorit 1944, Br. IV S, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇSH, në muajin maj 1944 u inkuadrua në Divizionin I S dhe mori pjesë në operacionin mësymës për çlirimim e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut. Në këtë operacion repartet e Br. IV S, me luftime të shumta kundër pushtuesit gjerman dhe forcave balliste, çliruan krahinat Qarishtë, Zerqan, Mat, Fushë Alie dhe në bashkëpunim edhe

me çetat territoriale çliruan qytetet e Dibrës dhe të Elbasanit. Në këto luftime të suksesshme për çlirimim e krahinave të Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, repartet partizane të Br. IV S patën një rritje të vazhdueshme, jo vetëm në përgatitjen luftarake, por në krahinat ku luftonin e dyfishuan efektivitetin e brigadës me partizanë vullnetarë të rinj, të cilët luftuan me vendosmëri dhe trimëri deri në çlirimim e plotë të vendit.

Pas luftimeve të shumta për çlirimim e Shqipërisë së Mesme dhe të Veriut, Br. IV S, së bashku me Br. I, VIII dhe XVII S, më 29 tetor 1944, me urdhër të Shtabit të Korparmatës së Parë mori pjesë në operacionin për çlirimim e Tiranës. Në Tiranë dhe rreth saj ishin përqëndruar gjermane e ballist, me detyrë për të mbrojtur Tiranën dhe për të siguruar tërheqjen e trupave gjermane nga Greqia për në Jugosllavi.

Në këtë operacion vendimtar për çlirimim e Tiranës, Br. I S iu ngarkua detyra të sulmonte armikun në veri të kryeqytetit, kurse Br. IV S iu ngarkua detyra të sulmonte në drejtimin kryesor më të fortifikuar të kryeqytetit, në rrugën Elbasan-Tiranë, në sektorin Pallati Mbretëror-Kodra e Kopilit-Kisha e Shën Prokopit, kurse Br. VIII S iu ngarkua detyra të sulmonte në drejtimin: Kazemat e Ali Rizajt, ndërsa Br. XVII S iu ngarkua detyra të luftonte në sektorin e Qafë Krrabës.

Repartet e Br. IV S, gjatë 45 ditëve luftime të vazhdueshme me autokolonat gjermane në Qafë Krrabë dhe me forcat gjermane që mbronin kryeqytetin, të mbështetura fuqishëm nga aviacioni anglo-amerikan, i cili çdo ditë bombardonte armikun në rrugëkalimin Qafë Krrabë-Tiranë, jo vetëm bllokoi lëvizjen e autokolonave armike, por pas luftimeve të rrufeshme trup me trup,



*Br. IV S, në të gjitha luftimet, nga krijimi deri në çlirimim e plotë të vendit, duke qenë një nga njësitë më të suksesshme të ushtrisë partizane, i plotësoi me nder detyrat e vëna dhe i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet të cilëve zëvendëskomandantin e brigadës Pano Xhamballa, komandantin trim Xhafer Lubonja, partizanët Riza Taçi, Neki Varvara, Kiço Korroveshi, Goie Ruço, Jonuz Selenica etj*

në betejën historike të Mushqetasë, arriti të shpartallojë dhe asgjësojë forcat gjermane. Në këtë betejë të përgatitur me kujdes dhe vendimtarë për çlirimim e kryeqytetit, efektiviteti i Br. IV S të lavdishme dha një kontribut të çmuar. Br. IV S, në betejën për çlirimim e Tiranës i dha atdheut 98 dëshmorë. Në të gjitha luftimet, nga krijimi deri në çlirimim e plotë të vendit, Br. IV S, duke qenë një nga njësitë më të



suksesshme të ushtrisë partizane, i plotësoi me nder detyrat e vëna dhe i dha atdheut 274 dëshmorë, ndërmjet të cilëve zëvendëskomandantin e brigadës Pano Xhamballa, komandantin trim Xhafer Lubonja, partizanët Riza Taçi, Neki Varvara, Kiço Korroveshi, Goie Ruço, Jonuz Selenica, etj. Për meritat dhe kontributin e saj në luftë, Br. IV S është dekoruar me Yllin Partizan të Klasis të Parë.

Rruga luftarake e Br. IV S, trimëria dhe heroizmi i luftëtarëve të saj në luftën për çlirimim e vendit, janë sot

një burim i madh frymëzimi për gjithë popullin, dhe veçanërisht për FA, në procesin e ndërtimit të demokracisë dhe mbrojtjen e atdheut.

Drejtimesit e Brigadës IV Sulmuese Komandant Nexhip Vinçani, lindi në Vinçan të Korçës në vitin 1916, në një familje atdhetare. Që kur ishte në Liceun e Korçës krijoi lidhje me elementë përparimtarë, me shoqërinë "Puna" dhe bashkëpunoi me revistën "Bota e Re". Studimet e larta i ndoqi në Itali, në Universitetin e Romës, në Fakultetin e Drejtësisë, por i ndërpreu dhe u kthye në atdhe. U lidh me LANÇ-in dhe zhvilloi veprimtari aktive antifashiste, duke u bërë një nga figurat kryesore të Luftës në qarkun e Korçës. Në qershor të vitit 1943 u caktua komandant i shtabit ushtarak për qarkun e Korçës dhe komandant i Brigadës IV S. Në nëntor 1944, u caktua zëvendëskomandant i Shtabit Operativ për çlirimim e Tiranës. Pas çlirimimit, kreu detyra të rëndësishme në ushtri si komandant divizioni në Peshkopi e në Shkodër, në Korçë, drejtor në Ministrinë e Mbrojtjes etj. Në provokacionet e gushtit të vitit 1949 të monarko-fashistëve grekë, ishte komandant i Grupi Operativ. Në vitin 1956 karriera e tij u ndërpre përfundimisht dhe më pas u denigrua, u burgos dhe u intenua nga regjimi komunist. Vdiq në Tiranë, më 6 shkurt 1997.

Komisar Pëllumb Dishnica lindi në fshatin Dishnicë të Korçës në vitin 1919. Kreu Liceun Kombëtar (francez) të Korçës. Pas pushtimit fashist u arrestua dhe u intenua në ishullin Ventotene, në Itali, në vitet 1939-1941. Kur u kthye

në atdhe kaloi në ilegalitet. U caktua komisar i Shtabit të Qarkut të Korçës, në maj, 1943. Ishte ndër organizatorët e formacioneve të armatosura partizane. U caktua komisar i Brigadës IV S që në krijimin e saj, më pas komisar i Divizionit I. Pas çlirimimit u emërua zëvendësdrejtor i Drejtorisë Politike të Ushtrisë Shqiptare, në vitin 1945 me gradën kolonel. Më pas, në vitin 1949 nga regjimi komunist u përjashtua nga ushtria dhe u intenua për 25 vjet në ishullin e Zvernecit dhe në fshatra të Myzeqesë. Vdiq në vitin 1989.

# "IN MEMORIA", koncert në nderim të Ansamblit Artistik të Ushtrisë

**N**ë sallën e shfaqjeve të Akademisë së Arteve u zhvillua veprimtaria artistike "In Memoria"

kushtuar Ansamblit Artistik të Ushtrisë. Ky aktivitet ishte përparuar nga Ministria e Mbrojtjes dhe QKMBMMSHP, nën kujdesin e veçantë të ministres së Mbrojtjes, znj. Mimi Kodheli. Koncerti solli në kujtesë të të pranishmëve në sallë figurat e njohura themeluese të Ansamblit, si dhe figurat e artistëve të mëdhenj të ndarë tashmë nga jeta si: Gaqo Avrazi, Kujtim Laro, Vaçe Zela, Mentor Xhemali, Pandi Zguro, Tonin Tërshana etj. Koncerti u drejtua nga prezantuesja ikonë e Ansamblit të Ushtrisë, znj. Flutura Çangu.

